# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5816
E martë, 2 korrik 2019
çmimi 0.40 €


## Presidenti kritikon ndërkombëtarët për mosndëshkimin e krimeve serbe FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI FAQE 4-5

# PS-ja më 30 qershor ridëshmoi se e ka mazhorancën e përkrahjes së sovranit



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se nuk ka pasur rrugëdalje tjetër përveç mbajtjes së zgjedhjeve lokale në Shqipëri. Ai ka thënë se nuk ka qenë problem çështja e datës së zgjedhjeve sa këmbëngulja e opozitës që Rama të dorëhiqet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka deklaruar se nuk ka pasur pjesëmarrje të vogël të qytetarëve në zgjedhjet e 30 qershorit por, sipas tij, ka pasur pjesëmarrje normale për rrethanat e bojkotit nga opozita. Maliqi ka thënë se PS-ja dhe kryeministri Edi Rama të dielën kanë ridëshmuar se ende i kanë votat e mazhorancës, 700 mijë sosh. Ai ka thënë se pas këtij procesi zgjedhor PD-ja dhe LSI-ja duhet ta reflektojnë gjendjen e tyre të brendshme për t'u konsoliduar si parti

# Qeveria e Kosovës hap dyqane të përkohshme në veri

Pasi serbët lokalë kanë mbyllur të gjitha dyqanet në veri të Mitrovicës, Qeveria e Kosovës, për t'u dalë në ndihmë qytetarëve në këtë pjesë, ka hapur pikat shitëse në bashkëpunim me bizneset. Mbylljen e dyqaneve, me pretekstin se nuk kanë produkte të nevojshme për shitje, liderët institucionalë e kanë vlerësuar si përpjekje e dështuar e Serbisë për të simuluar krizë humanitare në këtë pjesë të Kosovës. Ndërsa njohësit e çështjeve të sigurisë kanë thënë për gazetën se skenari për improvizimin e krizës humanitare në veri është kërcënim për stabilitetin në vend





## Kalueshmëria e testit të maturës, 64.64 për qind FAQE 7

## OPINION

### KËSHILLTARËT E KADRI VESELIT, SIKUR PENELOPA E ODISEUT! F. 8



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

### ZGJEDHJE PËR ZGJIDHJE, APO ZGJEDHJE PËR LIDHJE?! F. 11



Ylber ÇITAKU

## AKTUALE

### KUVENDI KA MIRATUAR REZOLUTËN PËR NDALIMIN E MONOPOLIT NË HOMOLOGIM F. 5

## EKONOMI



### 'LIMAK'-U INVESTON 3 MILIONË EURO NË AEROPORTIN 'ADEM JASHARI' F.9

### CERTIFIKOHEN 112 GRA NË FUSHËN E NDËRMARRËSISË DHE PLANEVE TË BIZNESIT F.9

## SPORT

### PRISHTINA KËRKON KUALIFIKIMIN F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Kryemadhi: Opozita e bashkuar, përgjegjësi për zgjidhjen e krizës politike




TIRANË, 1 KORRIK - "Shqiptarët folën qartë të dielën me mospjesëmarrjen e tyre masive dhe fjala e tyre tashmë është përgjegjësi e madhe për ne", deklaroi kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, në një deklaratë për mediet.
Më tej, Kryemadhi theksoi se opozita e bashkuar duhet të marrë përsipër për të zgjidhur krizën politike. "Opozita e bashkuar me të gjithë faktorët politikë dhe jopolitikë duhet të marrë përsipër zgjidhjen e krizës. Sot shqiptarët presin nga opozita një Shqipëri që u ofron atyre një shtet dhe sistem të barabartë, i garanton votën e lirë dhe të drejtën e zgjedhjes. Shqiptarët sot presin një ekonomi që u garanton të ardhmen dhe jo t'i asfiksojë ata. Sot shqiptarët presin nga opozita që t'u japë fund vuajtjeve dhe makthit që ata kanë nga pasiguria dhe largimi i fëmijëve të tyre nga vendi", tha ajo.
Më tej Kryemadhi theksoi se "për LSI-në, ky rezultat i së dielës është pikënisja e një përgjegjësie shumë të madhe. Shqiptarët të dielën shpëtuan veten dhe Shqipërinë", tha Kryemadhi.

# Socialistët fitojnë të gjitha bashkitë në Shqipëri

**Në zgjedhjet e së dielës të cilat u mbajtën pa opozitën, Partia Socialiste fitoi në 61 bashkitë e Shqipërisë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri me dije se pjesëmarrja në votime në të gjithë Shqipërinë ishte 21.6 %**

Tiranë, 1 korrik - Partia Socialiste në Shqipëri fitoi në 61 bashkitë e këtij vendi në zgjedhjet lokale të 30 qershorit të cilat u mbajtën pa opozitën. Në 31 nga 61 bashkitë, Partia Socialiste ka qenë pa asnjë kundërkandidat, ndërsa në 30 të tjerat kanë garuar kandidatë të pavarur apo kandidatë të partive të vogla.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri me dije se pjesëmarrja në votime në të gjithë Shqipërinë ishte 21.6 %. Opozita ndërkohë, siç deklaroi dhe kryetari demokrat Lulzim Basha, po flet për manipulime masive të procesit. Ndërsa shifra e 21.6 për qind e pjesëmarrjes e deklaruar të dielën në mbrëmje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve cilësohet e rreme, të hënën përfaqësuesit e opozitës thanë se "Edi Rama po kryen një manipulim masiv të rezultatit të votimit të tij monist, ku vetë votoi, vetë numëroi, vetë vulosi", u shpreh përfaqësuesi ligjor i Partisë Demokratike, Ivi Kaso. "Në votimet moniste të Edi Ramës dalin më shumë vota në kuti sesa ishte pjesëmarrja zyrtare e deklaruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, edhe ky nën kontrollin e Edi Ramës dhe që manipuloi gjatë gjithë ditës pjesëmarrjen e votuesve", u shpreh Kaso, duke iu referuar mospërputhjes së shifrave në të paktën 6 bashki. Të njëjtin fakt e kish denoncuar më parë edhe nënkryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim Petrit Vasili.
Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, i cili i ka anuluar zgjedhjet e së dielës përmes shfuqizimit të dekretit të mëparshëm për këtë ditë, ka caktuar një datë të re të zgjedhjeve lokale në vend. Ai ka dekretuar 13 tetorin si ditë kur qytetarët e Shqipërisë do të votojnë për kryetarët e bashkive të tyre.
Meta, të hënën përmes një postimi në Facebook, tha e "Shqipëria shpëtoi nga kurthi i përplasjes civile, ndaj i falënderoj nga zemra të gjithë shqiptarët që nuk ranë viktimë e retorikës konfrontuese të liderëve të papërgjegjshëm, që përmes nxitjes së dhunës duan të fshehin skandalet dhe llogaridhënien e tyre". Ai ka shtuar se sa i takon tejkalimeve të planit në votimet socialiste, asnjë surprizë nuk kishte. "Tani me duhet të 'shpik' një dekoratë të re, që besoj me ndihmën e Kuvendit socialist do miratohet, atë të 'Heroit të votave socialiste'", ka shkruar Meta.
Në anën tjetër, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në fjalimin e mbajtur pas mbylljes së vendvotimeve, e cilësoi 30 qershorin si "moment historik".



Vlefshmëria kushtetuese e votimeve të ditës së diel, por edhe vendimi i presidentit për t'i anuluar ato do të mund të vërtetohen vetëm pas krijimit të Gjykatës Kushtetuese, gjë për të cilën të gjithë akterët e përfshirë po bëjnë thirrje që të ndodhë sa më parë.
Shqipëria, tash e sa kohë, është përfshirë nga një krizë politike dhe protesta të opozitës kundër pushtetit.
Pas takimit me kryetarin e Partisë Demokratike, aleatët e tij, Fatmir Mediu dhe Mesila Doda iu përgjigjën interesit të medies, por nuk dhanë detaje për atë se çfarë është diskutuar në takim me liderin e selisë blu.
Kryetari i Partisë Republikane tha se raporti paraprak i OSBE/ODIHR tregoi se në zgjedhjet e së dielës asnjë nga kushtet e saj nuk është plotësuar. Të pyetur se nëse opozita do t'i vijojë protestat, Mediu dhe Doda treguan se edhe protestat janë mjete demokratike që do garantojnë lirinë e votës, ndërsa shtuan se një vendim i tillë ende nuk ka marrë "firmën finale".
Sipas Mediut, "Raporti i OSBE-së tregon se nuk është plotësuar asnjë kusht. Shqiptarët e dinë se çfarë ka ndodhur. Mendoj se çdo gjë që garanton zgjedhje të lira dhe të ndershme, duhet të vijohet".
Ndërsa Mesila Doda tha se "zgjedhjet e kësaj radhe vërtetuan qëndrimin tonë prej kohësh". E pyetur nëse do të nisin protestat, Doda tha se ky vendim do të merret gjatë ditëve në vijim.

## Padi kundër Vulinit për gjuhë të urrejtjes kundër shqiptarëve



PRESHEVË, 1 KORRIK - Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginën e Preshevës, Ragmi Mustafa, ka ngritur padi kundër ministrit të Mbrojtjes të Serbisë, Aleksandar Vulin, për shkak të, siç thuhet, gjuhës së tij të urrejtjes.
Mustafa tha për agjencinë serbe të lajmeve "Beta" se padinë e ka ngritur më 25 qershor në Gjykatën e Lartë në Beograd, pasi Vulin, disa herë, i ka quajtur publikisht shqiptarët "shqiptari" dhe atë me ton përbuzës.
Ai tha se për Këshillin Kombëtar Shqiptar është e papranueshme që gjuha e urrejtjes, me të cilën ofendohet një pakicë dhe e cila vjen nga një minister i Mbrojtjes, të konsiderohet si qasje individuale. "Ky mentalitet flet për qeverinë e sotme të Serbisë dhe për Serbinë zyrtare", tha Mustafa, transmeton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropa e Lirë. "Respekti për minoritetet është edhe detyrim ligjor dhe kushtetues i qeverisë dhe respektimi dhe pranimi i tjetrit është parakusht për një shoqëri demokratike", tha Mustafa.
Gjuhë të ngjashme ndaj shqiptarëve kanë përdorur edhe zyrtarë të tjerë serbë.
Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, në një komunikatë zyrtare të lëshuar gjatë javës së dytë të muajit prill i ka quajtur shqiptarët me termin "shqiptari".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kosova i përgjigjet simulimit të katastrofës humanitare nga ana e Serbisë në pjesën e veriut

# Qeveria e Kosovës hap dyqane të përkohshme në veri

**Pasi serbët lokalë kanë mbyllur të gjitha dyqanet në veri të Mitrovicës, Qeveria e Kosovës, për t'u dalë në ndihmë qytetarëve në këtë pjesë, ka hapur pikat shitëse në bashkëpunim me bizneset. Mbylljen e dyqaneve, me pretekstin se nuk kanë produkte të nevojshme për shitje, liderët institucionalë e kanë vlerësuar si përpjekje e dështuar e Serbisë për të simuluar krizë humanitare në këtë pjesë të Kosovës. Ndërsa njohësit e çështjeve të sigurisë kanë thënë për gazetën se skenari për improvizimin e krizës humanitare në veri është kërcënim për stabilitetin në vend**




EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 KORRIK - Serbët në veri të Mitrovicës kanë mbyllur të gjitha dyqanet të hënën në mëngjes. Ata kanë bërë me dije se një veprim të tillë e kanë bërë për shkak të taksës dhe pamundësisë së biznesmenëve nga Kosova veriore për t'u marrë me aktivitetet e tyre.

Institucionet e Kosovës e kanë kundërshtuar një gjë të tillë, duke thënë se ky është vetëm inskenim i një krize humanitare nga ana e Serbisë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se kjo përpjekje e Serbisë është e dështuar. "Krizë humanitare nuk ka në Kosovë. Mund të ketë improvizim dhe tendenca të Serbisë për t'i paraqitur si viktimë qytetarët serbë në veri të Kosovës. Prandaj, është shumë me rëndësi që e gjithë bota demokratike e njeh dhe e kupton realitetin, siç është edhe në veri dhe ky pretendim i ri i Serbisë është i dështuar", ka thënë Thaçi pas konferencës "Të gjithë së bashku me një zë" që është organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës.

Ndërsa Qeveria e Kosovës, për t'u dalë në ndihmë qytetarëve serbë në veri, ka hapur pikat shitëse në bashkëpunim me bizneset. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka njoftuar se këtë e ka bërë pas konsultimeve me të gjitha institucionet përkatëse, duke shtuar se simulimi i katastrofës humanitare nga ana e Serbisë është një tjetër përpjekje e dështuar për destabilizim. "Qeveria e Kosovës mbron qytetarët në veri, duke hapur pikat shitëse në bashkëpunim me bizneset kosovare. Simulimi i katastrofës humanitare nga ana e Serbisë është një tjetër përpjekje e dështuar për destabilizim. Pas demaskimit të këtij skenari, të paralajmëruar kohë më parë, Qeveria e vendit mbetet e përkushtuar për të ofruar siguri për të gjithë qytetarët e saj, pa dallim! Në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin e biznesit në Republikën e Kosovës dhe pas konsultave me të gjitha institucionet përkatëse, kemi organizuar hapjen e pikave të përkohshme shitëse me pakicë në veriun e vendit. Ky aksion, i koordinuar dhe planifikuar, ka për qëllim ofrimin e të gjitha produkteve elementare për banorët e asaj ane", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas tij, kjo përgjigje e qeverisë e vulos sovranitetin e Republikës së Kosovës në këtë pjesë. "Sot edhe një herë ua kemi dhënë përgjigjen institucionale të gjitha veprimeve të orkestruara nga Serbia, përgjigje e cila vulos sovranitetin e vendit, solidaritetin qytetar, përgjegjësinë dhe kujdesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës ndaj të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Asnjë qytetar i Kosovës nuk do të jetë viktimë e luftës speciale që orkestrohet nga agjentë të jashtëm. Kosova është shtet që ne e ndajmë bashkë si shoqëri", ka shkruar Haradinaj.

Kurse njohësi i çështjeve të sigurisë dhe ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se skenari për improvizimin e krizës humanitare në veri është kërcënim për stabilitetin në vend. Ai ka deklaruar se siguria kombëtare vazhdon të jetë e kërcënuar për aq kohë sa Serbia pengon funksionimin normal të shtetit të Kosovës. "Pra, për sa kohë që Serbia, e përkrahur nga Rusia, manipulon politikanë lokalë serbë, pengon funksionimin normal të institucioneve tona shtetërore, lokale dhe qendrore në veri dhe jo vetëm, konsideroj se siguria kombëtare është jostabile. Integriteti territorial është i mbrojtur si mos më mirë (KFOR-i është përgjegjës), por i kërcënuar vazhdon të mbetet ushtrimi i plotë i sovranitetit kudo dhe ndaj çdokujt brenda territorit tonë. Janë shumë shqetësues skenarët e fundit të improvizimit të krizave humanitare në veri të Mitrovicës dhe inkurajoj që sa më shumë të demaskohet çdo propagandë e tillë. Druaj se në këtë lojë është edhe e ashtuquajtura Qendra Ruso-serbe për Kriza Humanitare. Prandaj skenari i krizës së improvizuar humanitare në veri është kërcënim për stabilitetin", ka deklaruar Selimi.




## Nisen kontingjentet me ushqim në veri

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, të hënën ka nisur kontingjentet me ushqim në veri të vendit. "Zhvillimi i biznesit, ofrimi i produkteve ushqimore për secilin qytetar të vendit është nevojë esenciale dhe, si e tillë, është obligim yni qytetar si përfaqësues të institucioneve të Kosovës. Bizneset kosovare qëndrojnë pranë qytetarëve tanë në veri të vendit, duke iu ofruar produkte esenciale ushqimore në mënyrë që të mos iu mungojë asgjë", ka thënë Shala. Ai ka theksuar se do të vazhdojnë ta shtrijnë sovranitetin e vendit në çdo pjesë të territorit të Kosovës. "Ne do të vazhdojmë ta shtrijmë sovranitetin e vendit në çdo pjesë të 10,887 km2. Asnjë qytetari të Republikës së Kosovës nuk do t'i mungojë asnjë produkt. Tregu ynë është i hapur dhe ofron të gjitha produktet e nevojshme për një jetë të dinjitetshme për secilin qytetar të vendit", ka deklaruar Shala.

## Ngrihet aktakuzë kundër ish-ministrit Teodosijeviq

PRISHTINË, 1 KORRIK - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës tha se ka ngritur aktakuzë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë kundër të pandehurit I. T., pasi që në cilësinë e ministrit në Qeverinë e Republikës së Kosovës ka nxitur dhe përhapur publikisht urrejtje, përçarje dhe mosdurim midis grupeve kombëtare, racore dhe etnike që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Bëhet fjalë për ish-ministrin e Administratës së Pushtetit Lokal, Ivan Teodosijeviq, i cili, gjatë një organizimi për ta shënuar 20-vjetorin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë në muajin mars, ka thënë se "arsye për agresionin e NATO-s ka qenë e ashtuquajtura katastrofë humanitare në Kosovë dhe masakra e trilluar e Reçakut". "Me këto veprime I. T. ka kryer veprën penale: nxitje e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik", thuhet në njoftimin e Prokurorisë.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka shkarkuar nga detyra Teodosijeviqin më 9 prill. Haradinaj, më 25 mars, e ka liruar nga detyra edhe zëvendësministren e Drejtësisë, Vesna Mikiq, pasi kjo e fundit ka deklaruar se bombardimet e NATO-s mbi caqet e ish-Jugosllavisë "ishin gjenocid ndaj shtetit dhe popullit serb".

Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

# PS-ja më 30 qershor ridëshmoi se ka




Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se nuk ka pasur rrugëdalje tjetër përveç mbajtjes së zgjedhjeve lokale në Shqipëri. Ai ka thënë se nuk ka qenë problem çështja e datës së zgjedhjeve sa këmbëngulja e opozitës që Rama të dorëhiqet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka deklaruar se nuk ka pasur pjesëmarrje të vogël të qytetarëve në zgjedhjet e 30 qershorit por, sipas tij, ka pasur pjesëmarrje normale për rrethanat e bojkotit nga opozita. Maliqi ka thënë se PS-ja dhe kryeministri Edi Rama të dielën kanë ridëshmuar se ende i kanë votat e mazhorancës, 700 mijë sosh. Ai ka thënë se pas këtij procesi zgjedhor PD-ja dhe LSI-ja duhet ta reflektojnë gjendjen e tyre të brendshme për t'u konsoliduar si parti

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 1 KORRIK - Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë të hënën se zgjedhjet në Shqipëri nuk kanë qenë normale pa pjesëmarrjen e opozitës por, sipas tij, nuk ka pasur rrugëdalje tjetër pasi që opozita ka kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Rama si kusht që të marrë pjesë në zgjedhje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se opozita me opstrukcionin e institucioneve dhe djegien e mandateve ka dashur ta çonte vendin në krizë totale dhe zgjedhje të parakohshme. "Mjeti i fundit që i mbet ishte bojkoti i zgjedhjeve, më pastaj edhe loja me dekretimin dhe çdekretimin e datës së zgjedhjeve, ku presidenti Meta u tregua si argat i opozitës por, pa sukses", është shprehur Maliqi, i cili ka qenë këshilltar i kryeministrit Rama në mandatin e kaluar.

Ai ka deklaruar se nuk ka qenë problem çështja e datës së zgjedhjeve sa këmbëngulja e opozitës që Rama të dorëhiqet.

## Kuvendi ka miratuar rezolutën për ndalimin e monopolit në homologim

PRISHTINË, 1 KORRIK - Me 62 vota për dhe dy abstenime, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar të hënën rezolutën për ndalimin e monopolit në homologim. Rezoluta e prezantuar nga deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Zharku, kërkon shfuqizimin e udhëzimit administrativ të vitit 2018 dhe fillimin e plotësimndryshimit të Projektligjit për automjete. Po ashtu, rezoluta kërkon që në afat prej dy muajve të miratohet udhëzimi i ri administrativ, ndërsa në afat prej gjashtë muajve të liberalizohet tregu i homologimit të automjeteve. Harmonizimin e kësaj rezolute deputetët e bënë gjatë kohës sa ishte duke u mbajtur seanca e jashtëzakonshme për shqiptarët e Luginës së Preshevës.



# mazhorancën e përkrahjes së sovranit




"PD-ja dhe LSI-ja nuk patën lënë vend për konsensus, sepse edhe për datën e korrigjuar që Meta e la më 13 tetor nuk e pranuan, sërish kërkonin të ikë Rama. Ky nuk e pranoi, por u organizuan zgjedhjet në afatin ligjor edhe pa pjesëmarrjen e opozitës, thjesht për ta treguar se PS-ja dhe personalisht Rama ende i kanë votat e mazhorancës", ka thënë ai.

Maliqi ka vlerësuar se nuk ka pasur pjesëmarrje të vogël të qytetarëve në zgjedhjet e 30 qershorit por, sipas tij, ka pasur pjesëmarrje normale për rrethanat e bojkotit nga opozita. "21.6 për qind duhet të lexohet si 700 mijë vota, që është një lloj konstante në zgjedhjet e viteve 2013, 2015 dhe 2017. PS-ja çdoherë ka marrë këtë përqindje me plus minus 2-3 për qind, çka është statistikisht në suazat e normales. Nëse nuk do të kishte bojkot të opozitës, pjesëmarrja e përgjithshme do të ishte rreth 50 për qind nga votuesit e regjistruar, që janë mbi 3.4 milionë. Nëse edhe opozita do të merrte pjesë në zgjedhje, pjesëmarrja e përgjithshme e elektoratit aktiv do të ishte mbi 70 për qind", ka theksuar Maliqi, duke shtuar se PS-ja të dielën ka ridëshmuar se e ka mazhorancën e përkrahjes së sovranit. "PS-ja dhe Rama kanë ridëshmuar se e kanë mazhorancën e përkrahjes së sovranit, pra se mbështeten nga elektorati më i madh në vend që legjitimon plotësisht pushtetin qendror. Ndërkaq që në nivelin lokal ka ndodhur një çrregullim serioz me fajin e vet opozitës sepse PS-ja e ka marrë pushtetin absolut edhe në bashkitë ku nuk e ka mazhorancën faktike", ka deklaruar Maliqi.

Ai ka thënë se PD-ja dhe LSI-ja duhet ta reflektojnë gjendjen e tyre të brendshme për t'u konsoliduar si parti. "Nëse nuk e bëjnë këtë mund të paraqiten edhe subjekte dhe liderë të ri politikë që do t'i artikulojnë më mirë kërkesat e elektoratit të djathtë, por edhe të majtë, sepse as PS-ja nuk është më parti tipike e majtë, por një amalgamë sipas shijes së Ramës", është shprehur Maliqi.

**"Epoka e re":** *Z. Maliqi, si e komentoni mbajtjen e zgjedhjeve lokale në Shqipëri, pjesë e të cilave nuk ishin partitë kryesore opozitare, PD-ja dhe LSI-ja?*

**Maliqi:** Zgjedhjet nuk kanë qenë normale pa pjesëmarrjen e opozitës, por nuk ka pasur rrugëdalje tjetër pasi që opozita kërkonte dorëheqjen e kryeministrit Rama si kusht që të marrë pjesë në zgjedhje. Këto kanë qenë zgjedhje për pushtetin lokal, kurse opozita me opstrukcionin e institucioneve dhe djegien e mandateve në Kuvendin e Shqipërisë dëshironte ta çonte vendin në krizë totale dhe në zgjedhje të përgjithshme të parakohshme. Mjeti i fundit që i mbet ishte bojkoti i zgjedhjeve, më pastaj edhe loja me dekretimin dhe çdekretimin e datës së zgjedhjeve ku presidenti Meta u tregua si argat i opozitës por, pa sukses.

**"Epoka e re":** *Është dashur të mbahen këto zgjedhje në këtë mënyrë apo konsideroni se palët do të duhej të arrinin konsensus për një datë tjetër, e jo për 30 qershorin dhe 13 tetorin?*

**Maliqi:** Nuk ishte problem çështja e datës sa këmbëngulja e opozitës që Rama të dorëhiqet. PD-ja dhe LSI-ja nuk patën lënë vend për konsensus, sepse edhe për datën e korrigjuar që Meta e la më 13 tetor nuk e pranuan, sërish kërkonin të ikë Rama. Ky nuk e pranoi, por u organizuan zgjedhjet në afatin ligjor edhe pa pjesëmarrjen e opozitës, thjesht për ta treguar se PS-ja dhe personalisht Rama ende i kanë votat e mazhorancës.

**"Epoka e re":** *Sidoqoftë, zgjedhjet janë mbajtur, por ka pasur një dalje të vogël të qytetarëve në votime, 21 për qind. Pse ndodhi një gjë e tillë?*

**Maliqi:** Nuk është absolutisht dalje e vogël, por normale për rrethanat e bojkotit nga opozita. 21.6 për qind duhet të lexohet si 700 mijë vota, që është një lloj konstante në zgjedhjet e viteve 2013, 2015 dhe 2017. PS-ja çdoherë ka marrë këtë përqindje me plus minus 2-3 për qind, çka është statistikisht në suazat e normales. Nëse nuk do të kishte bojkot të opozitës, pjesëmarrja e përgjithshme do të ishte rreth 50 për qind nga votuesit e regjistruar që janë mbi 3.4 milionë. Por në këtë shifër, sikurse edhe në Kosovë, regjistri i mbanë me të drejtë vote të gjithë shtetasit shqiptarë, edhe ata që prej kohësh jetojnë në Greqi, Itali dhe vende të tjera dhe faktikisht, edhe pse e kanë të drejtën e votës, nuk e shfrytëzojnë këtë. Nëse do të mënjanonim këtë masë të madhe të shtetasve nga listat që zakonisht nuk votojnë, duke i llogaritur vetëm rreth 1.8 ose 1.9 milionë si votues aktivë dhe rezidentë, na del një numër tjetër e pjesëmarrjes që në këtë rast do të ishte rreth 45 për qind, që është numër i mjaftueshëm edhe për faktin se ligji shqiptar nuk ka përcaktuar limit të poshtëm të legjitimitetit të zgjedhjeve. Nëse edhe opozita do të merrte pjesë në zgjedhje, pjesëmarrja e përgjithshme e elektoratit aktiv do të ishte mbi 70 për qind.

**"Epoka e re":** *Ka humbur apo ka fituar PS-ja e kryeministrit Edi Rama në këto zgjedhje, sepse me mosdaljen e partive kryesore opozitare këto zgjedhje nuk marrin atë kreditin e merituar?*

**Maliqi:** PS-ja dhe Rama e kanë ridëshmuar se e kanë mazhorancën e përkrahjes së sovranit, pra se mbështeten nga elektorati më i madh në vend, gjë që legjitimon plotësisht pushtetin qendror. Ndërkaq që në nivelin lokal ka ndodhur një çrregullim serioz me fajin e vet opozitës sepse PS-ja e ka marrë pushtetin absolut edhe në bashkitë ku nuk e ka mazhorancën faktike.

**"Epoka e re":** *Çfarë do të ndodhë pas këtyre zgjedhjeve në Shqipëri, ku pushteti lokal absolut është i PS-së?*

**Maliqi:** Rama ka treguar ndjeshmëri për këtë situatë në komunat që janë tradicionalisht të kontrolluara nga PD-ja ose LSI-ja, duke thënë se asnjë administrator lokal në këto bashki nuk do ta humbë punën. Edhe për këtë problem mund të gjendet zgjidhja nëse fillojnë bisedimet e opozitës me PS-në, që eventualisht vitin tjetër të mbahen zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme dhe ato vendore. Nëse ka vullnet të mirë, kjo mund të ndodhë. Nuk ka qenë dëshira e PS-së dhe e Ramës që zgjedhjet të duken si farsë, por është përgjegjësia e opozitës që bëri veprime të padëgjuara në sistemet demokratike, si djegien e mandateve dhe bojkoti i pamenduar mirë i zgjedhjeve që opozitën e la pa asnjë pushtet. PD-ja dhe LSI-ja duhet ta reflektojnë gjendjen e tyre të brendshme për t'u konsoliduar si parti. Nëse nuk e bëjnë këtë mund të paraqiten edhe subjekte dhe liderë të ri politikë që do t'i artikulojnë më mirë kërkesat e elektoratit të djathtë, por edhe të majtë, sepse as PS-ja nuk është më parti tipike e majtë, por një amalgamë sipas shijes së Ramës.

## Funksionalizohet Departamenti Special i Gjykatës së Prishtinës



**Prishtinë, 1 korrik (ER)** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, e ka vlerësuar hap jashtëzakonisht të rëndësishëm funksionalizimin e Departamentit Special pranë Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

Përmes një deklarate për media Tahiri ka theksuar se me emërimin e gjyqtarëve që do të angazhohen në këtë departament, tani e tutje do t'i trajtojë ekskluzivisht lëndët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. "Jam shumë i lumtur që e gjithë ndërmarrësia ligjore me të cilën kemi arritur ta reformojmë sistemin e drejtësisë që nga viti i kaluar deri më sot si dhe masat e Agjendës 'Drejtësia 2020' kanë hyrë në kursin e duhur të realizimit. Në këtë drejtim, funksionalizimi i Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe Apelit është hap jashtëzakonisht vendimtar në këtë kurs të veprimit", ka thënë Tahiri.

# FSK-ja, pjesë e ushtrimit me partnerë ndërkombëtarë në Gjermani

**Prishtinë, 1 korrik (ER)** - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me partnerët ndërkombëtarë është duke marrë pjesë në Ushtrimin e Përbashkët KFOR 26, në Hohenfels të Republikës Federale të Gjermanisë. Ky ushtrim që organizohet për çdo vit ka për qëllim përgatitjen e nevojshme të njësive me mision në kuadër të KFOR-it.
Kontingjenti i FSK-së në këtë ushtrim po merr pjesë me 12 pjesëtarë në detyra të specifikuara si: Shtabi i FSK-së, Njësia e EOD-së dhe MKAB-së. Pjesëtarët janë akomoduar në Bazën e Ushtrisë Amerikane në Hohenfels, e cila njëherësh është bazë ku realizohen të gjitha trajnimet ndërkombëtare, me fokus të veçantë Evropën.
Ushtrimi po zhvillohet në pesë faza: arritja, zbarkimi, trajnimi, ushtrimi dhe rigjenerimi. Tani është duke u zhvilluar faza e tretë, ku njësitë e FSK-së deri më tani kanë marrë pjesë në stërvitjet e organizuara nga homologët e njësive përkatëse kryesisht të ushtrisë amerikane (Stërvitje për njësitë e EOD-së dhe MKAB-së), ku nëpërmjet skenarëve kanë kryer të gjitha koordinimet dhe përgatitjet me qëllim që njësitë të jenë të gatshme për përmbushjen e misionit gjatë ekzekutimit të ushtrimit. Gjithashtu, kontingjenti i FSK-së, përpos stërvitjeve në çminim dhe dekontaminim, kontribut të veçantë



është duke dhënë edhe në fushën e informimit.
Në këtë ushtrim të përbashkët njësitet përmes KFOR-it përgatiten për mision real në Kosovë. Pjesëmarrës në këtë ushtrim janë nga: ShBA-ja, Shqipëria, Italia, Sllovenia, Romania, Armenia, Moldavia, Lituania.
Ushtrimi i përbashkët KFOR 26 ka filluar të zhvillohet më 20 qershor, me zbarkimin e kontingjentit të FSK-së në Hohenfels dhe do të përfundojë më 11 korrik, ku pjesëtarët e FSK-së do të kthehen në Kosovë.

# A ka rrezik për mungesë të ujit të pijshëm në Kosovë?

**Prishtinë, 1 korrik** - Temperaturat e larta që kanë prekur shumë vende të Evropës kanë rikthyer një nga shqetësimet e shpeshta në Kosovë rreth rrezikut nga mungesa e sasisë së mjaftueshme të ujit të pijshëm për popullatën e këtushme.
Vala e nxehtësisë po parashihet ta përfshijë edhe Kosovën. Në raste të tilla, kur stina e verës karakterizohet me temperatura të larta e reshje të pakta shiu, kryesisht mund të sjellë si pasojë rënien e nivelit të ujit në liqenet akumuluese në vend, duke shkaktuar reduktime në furnizimin me ujë të pijshëm në disa zona.
Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila, krahas hartimit dhe zbatimit të politikave dhe legjislacionit, është përgjegjëse për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë, nuk kanë dhënë asnjë detaj lidhur me gjendjen dhe rezervat e ujit në vend. Megjithatë, një pasqyrë për gjendjen e kanë



dhënë në Shoqatën e Ujësjellësve të Kosovës (SHUKOS) e cila është organizatë joqeveritare e kompanive të ujësjellësve.
Kryetari i Bordit të SHUKOS-it, Muhamed Suliqi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se, përveç Komunës së Gjilanit, e cila ka probleme me rezervat e ujit, në zonat e tjera të Kosovës gjendja është stabile dhe nuk ka rrezik për ndonjë krizë të afërt të mungesës së ujit të pijshëm. "Sa i përket gjendjes së burimeve ujore, për momentin vetëm në Gjilan ka ndikuar thatësia, ndërsa Prishtina e ka bërë zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë të pijes prej Ibër-Lepencit. Ndërsa kompanitë e tjera Radoniqi, Hidroregjioni jugor, Hidrodrini, Bifurkacioni nuk i kanë këto probleme të theksuara të ujit sikurse Gjilani", ka vlerësuar Suliqi.
Derisa tregoi se edhe në liqenin e Badovcit vërehet rënie e nivelit të ujit, sipas Suliqit, Prishtina e ka rrezikun më të vogël pas ndërtimit të fabrikës në Shkabaj.
Rënien e nivelit të ujit në Badovc e kanë konfirmuar edhe në Ujësjellësin Rajonal "Prishtina". Kryeshefi ekzekutiv i kësaj ndërmarrjeje, Ilir Abdullahu, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se, pos Badovcit, rënie të lehtë ka edhe në Batllavë. Sipas tij, gjendja në Batllavë është shumë më e mirë, ndërsa në liqenin e Badovcit, i cili përveç vitit të kaluar kur kishte nivel maksimal, rënia e tanishme është e përafërt me nivelet e krahasuara ndër vite.
Megjithatë, Abdullahu vlerëson se "aktualisht situata është stabile, me furnizim të pandërprerë me ujë". Por, ai u bënë thirrje qytetarëve për kursim dhe moskeqpërdorim të ujit të pijshëm.
Sipas ekspertit të meteorologjisë, Sylë Tahirsylaj, edhe pse kjo verë do të jetë më e nxehtë sesa ajo e vitit paraprak, qytetarët e Kosovës nuk duhet të shqetësohen, pasi do të ketë reshje të shiut në nivel mesatar. "Sipas përllogaritjeve të kushteve atmosferike, përkatësisht të motit për këtë vit, rezulton që vit do të jetë pak më i nxehtë se viti i kaluar, për zero prejse tetë gradë (0.8), do të ketë reshje, do të ketë plotësim të liqeve me ujërat akumuluese, meqenëse muajin që po e lëmë pas ka pasur një sasi të reshjeve, kanë rënë diku mbi 100 litër për metër katror. Por, stina e verës i pakëson nivelet e ujëmbledhësve për arsye se ka keqpërdorim të ujit për ujitjen e fushës, të luleve, të kopshteve, të oborreve etj., por nuk ka nevojë që të shqetësohen qytetarët, për cilindo territor të vendit tonë, sepse do të ketë reshje dhe këto reshje janë në vlerat shumëvjeçare mesatare", ka thënë Tahirsylaj.
Aktualisht, qytetarët e Kosovës furnizohen nga disa burime natyrore dhe artificiale të ujërave.

## Certifikohen 112 gra në fushën e ndërmarrësisë dhe planeve të biznesit

**Prishtinë, 1 korrik (ER)** - Është mbajtur ceremonia e certifikimit të 112 grave dhe vajzave nga pesë rajone të Kosovës, në kuadër të projektit "Inkubatori i Biznesit për Gra", i cili financohet nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.
Zëvendësministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Bujar Cakolli, ka marrë pjesë në këtë ceremoni, ku ka ofruar përkrahje për gratë dhe vajzat e Kosovës në procesin e krijimit të bizneseve fillestare. "Ky projekt është ndër më të rëndësishmit për neve si ministri jo vetëm nga aspekti teknik, por edhe për nga koncepti dhe modeli i promovimit të ndërmarrësisë dhe inovacionit. Pozita e gruas në shoqërinë e Kosovës vazhdon të jetë jo e mirë, andaj përmes projekteve të tilla ne synojmë t'i fuqizojmë gratë e Kosovës në mënyrë që të kemi më shumë biznese që udhëhiqen nga gratë dhe vajzat", ka thënë zëvendësministri Cakolli. Ai ka theksuar se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është e përkushtuar për zhvillimin e ndërmarrësisë dhe iniciativës private nëpërmjet inovacionit, duke u përqendruar në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
Projekti "Inkubatori i Biznesit për Gra" ka ofruar trajnime profesionale në fushën e ndërmarrësisë dhe planit të biznesit. Faza e dytë e projektit do t'i ofrojë grantet e para për bizneset Start-Up dhe inkubimin e së paku dhjetë bizneseve të para Start-Up në Inkubatorin e Biznesit. Ky projekt zbatohet nga partnerët KW4W dhe IMD.



# Presidenti kritikon ndërkombëtarët për mosndëshkimin e krimeve serbe

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë të hënën se ka ndodhur një amnisti e heshtur e drejtësisë ndërkombëtare përballë shtetit të Serbisë dhe kriminelëve që kanë kryer krime në Kosovë. "Përpos që kërkojmë drejtësi, kërkojmë edhe qartësi pse po ndodhë kjo amnisti e heshtur nga faktori ndërkombëtar, për të cilat edhe ka ndodhur bombardimi", është shprehur Thaçi në konferencën "Të gjithë së bashku me një zë", e cila është organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës në mbështetje të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 KORRIK - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën ka marrë pjesë në konferencën "Të gjithë së bashku me një zë", e cila është organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës në mbështetje të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.
Presidenti Thaçi ka thënë se jo vetëm të mbijetuarat e dhunës seksuale, por e gjithë shoqëria jonë ka pasur nevojë për një zë tonin të përbashkët, për përkrahje të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Duke e konsideruar shumë të qëlluar dhe shumë të nevojshme këtë konferencë, ku pjesë e saj ishin edhe klerikë të shumtë fetarë dhe përfaqësuese të organizatave të shoqërisë civile, që me vite janë përkujdesur dhe i kanë mbështetur të mbijetuarat, presidenti Thaçi ka thënë se duhet të kërkojmë më shumë përkrahje prej tërë shoqërisë. "Të mbijetuarat e dhunës seksuale kanë nevojë për më shumë përkrahje institucionale dhe shoqërore. Kanë nevojë për përkrahje më të fuqishme dhe për më shumë mirëkuptim brenda familjes, komunitetit dhe shoqërisë sonë", ka thënë Thaçi.
Kreu i shtetit ka thënë se fajësia e kësaj padrejtësie të rëndë, ende edhe pas 20 vjetësh, fatkeqësisht vazhdon të peshojë mbi vetë viktimat e dhunës seksuale. "Shoqëria jonë duhet të ndërgjegjësohet dhe të bëjë më shumë për të mbijetuarat. Të gjithë së bashku duhet ta luftojmë stigmatizimin e viktimave të dhunës seksuale. Lufta për ne ka mbaruar në vitin 1999, por për të mbijetuarat e dhunës seksuale nuk ka mbaruar asnjëherë. Për shkak të frikës nga stigmatizimi, i cili nuk do të duhej të ishte i pranishëm në shoqërinë tonë, të mbijetuarat ende vazhdojnë të vuajnë në heshtje", ka thënë presidenti Thaçi.
Ai ka thënë se si shumë krime të tjera, edhe dhunimet ishin mjet lufte për kriminelët serbë, për shtetin e Serbisë. "Ishin krime makabre për të na poshtëruar, për të na thyer dhe për të na shkatërruar nderin e dinjitetin. Me çdo kusht u munduan të na zhveshin prej çfarëdo vlere njerëzore, të na nëpërkëmbin, të na turpëronin deri te përjashtimi dhe izolimi i njëri-tjetrit", ka theksuar ai.
I pari i vendit ka thënë se të mbijetuarat e dhunës seksuale nuk janë fajtore për të kaluarën e tyre, e cila është pjesë edhe e të kaluarës së popullit dhe shtetit tonë. "Ato janë viktima që më shumë se të gjithë kanë nevojë për përkrahjen tonë, të shtetit, institucioneve dhe gjithë qytetarëve të Kosovës. Shoqëria jonë kurrë nuk duhet të lejojë që kriminelët e shtetit të Serbisë t'ia arrijnë qëllimit të tyre. Këtë duhet ta themi të gjithë shumë qartë: nuk duhet të lejojmë!", ka thënë ai.
Presidenti Thaçi ka thënë se duhet të flasim ashtu siç ka folur Vasfije Krasniqi Goodman dhe të kërkojmë drejtësi për mijëra viktima të dhunës seksuale, të ushtruar nga forcat policore dhe ushtarake të shtetit të Serbisë gjatë luftës në Kosovë. "Krimet e luftës nuk vjetrohen, por duke mos folur, duke mos i raportuar, ato amnistohen. Prandaj, asnjëherë nuk është vonë për t'i raportuar rastet, sepse vetëm me angazhim dhe bashkëpunim konkret, me zbatim të drejtë të ligjit, mund të sigurohet drejtësi për viktimat dhe të kërkohet përgjegjësi nga kriminelët që i kryen këto krime të udhëhequra nga shteti i Serbisë", ka thënë Thaçi.
Presidenti i vendit ka thënë se, përpos dhunës seksuale, shteti i Serbisë ka kryer edhe spastrim etnik dhe gjenocid në Kosovë, ka dëbuar rreth një milion qytetarë të Kosovës dhunshëm nga shtëpitë dhe pronat e tyre, ka kryer rreth 400 masakra anekënd Kosovës kundër civilëve vetëm pse ishin shqiptarë, ka vrarë rreth 1 300 fëmijë vetëm pse ishin shqiptarë. "Ka ndodhur një amnisti e heshtur e drejtësisë ndërkombëtare përballë shtetit të Serbisë dhe kriminelëve që kanë kryer krime në Kosovë. Përpos që kërkojmë drejtësi, kërkojmë edhe qartësi pse po ndodhë kjo amnisti e heshtur nga faktori ndërkombëtar, për të cilat edhe ka ndodhur bombardimi", është shprehur Thaçi.
Kreu i shtetit ka thënë se për dhjetë vjet ishte administrata e UNMIK-ut dhe asnjë kriminel serb nuk është i dënuar për dhunën seksuale. As tribunali i Hagës, sipas presidentit Thaçi, as që është marrë me këto çështje. "EULEX-i ka bërë përpjekje, por nuk ka pasur sukses. Prandaj, viktimat jo vetëm se kanë nevojë për mbështetje, jo vetëm që duhet t'i duam, t'i respektojmë e nderojmë, por kërkojnë edhe drejtësi dhe adresa për të kërkuar drejtësi është shumë e qartë, është Beogradi zyrtar. Ata njerëz që e kanë organizuar dhe udhëhequr këtë dhunë sistematike, këto krime makabre, janë në Parlamentin e Serbisë, në Qeverinë e Serbisë, në institucionet më të larta të sigurisë së shtetit të Serbisë dhe, në një formë a formën tjetër, heshtet nga bashkësia ndërkombëtare", ka shtuar presidenti Thaçi.

# Kalueshmëria e testit të maturës, 64.64 për qind

EPOKA E RE Qendresa RAMA




PRISHTINË, 1 KORRIK - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në një konferencë për medie të hënën, ka bërë me dije rezultatet e afatit të parë të provimit të Maturës Shtetërore 2019, sipas të cilave, nga 27 081 maturantë që i janë nënshtruar provimit, kanë kaluar 17 504, ose 64.64 për qind.
Ministri Bytyqi, me këtë rast, ka falënderuar Komisionin Shtetëror të Maturës (KShM), për të cilin ka thënë se ka bërë një punë të jashtëzakonshme në këtë periudhë e, po ashtu, edhe të gjithë aktorët e angazhuar për mbarëvajtjen e provimit të maturës. "Është një lajm i mirë se këtë vit kemi një test të maturës, i cili është më i suksesshmi sa i përket monitorimit dhe mbarëvajtjes së tij", ka thënë ministri Bytyqi, duke shtuar se kjo ka bërë që të kemi edhe rezultate më të ulëta në krahasim me vitin e kaluar kur kalueshmëria ka qenë 73.26 për qind.
Ministri Bytyqi ka folur edhe për masat që janë marrë nga ana e KShM-së për të gjithë ata që kanë shkelur rregullat e përcaktuara nga ky komision. Në këtë drejtim janë përjashtuar nga testi 270 nxënës për shkak të përdorimit të telefonave, ndërsa në qendrën e testimit në shkollën "Don Bosko" në Gjilan për klasën XII do të përsëritet pjesa e parë e testit më 3 korrik për shkak se është vlerësuar se ka pasur kopjim gjatë testit.
Sa iu përket masave që janë marrë ndaj administruesve që nuk i kanë respektuar rregullat, pesë administrues janë dënuar me mosushtrim të përhershëm të kësaj detyre dhe me kundërvajtje 300 euro gjobë dhe tre të tjerë me mosushtrim të përhershëm të detyrës në testin e maturës.
Ministri Bytyqi, po ashtu, ka theksuar faktin se sot janë shpërndarë certifikatat falas nga ana e MAShT-i për të gjithë maturantët të cilët e kanë kaluar provimin e maturës. Në afatin e parë të provimit të Maturës Shtetërore 2019, kalueshmëria në mësimin në gjuhën shqipe është 64.40 për qind, në gjuhën boshnjake 85.43 për qind dhe në gjuhën turke 69.47 për qind.

# KËSHILLTARËT E KADRI VESELIT, SIKUR PENELOPA E ODISEUT!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

**Rrobat e reja, me stof të vjetër dhe të rrëzbitur:** Kryetari i Kuvendit dhe kryetari i rizgjedhur i PDK-së, Kadri Veseli, sa e mori, pa asnjë kundërshtim udhëheqjen e partisë edhe për një mandat tjetër, doli me një propozim, që në rrethanat e Kosovës mund të llogaritet si revolucionar: vendosjen e një standardi ligjor dhe moral për bartësit e pozitave të larta institucionale dhe partiake për anëtarët e partisë që po e drejton duke e pasur si violinë të parë, Hashim Thaçin, aktualisht president i Kosovës. Të gjithë ata që kanë njohuri elementare nga muzika e kanë të qartë faktin se në një orkestër apo filarmoni, roli i violinës së parë është më i rëndësishëm se i vet dirigjentit për faktin se, nëse ka dëshirë mund t'ia bëjë punën lesh dirigjentit. Prandaj, në koncertin e Filarmonisë së Vjenës, në çdo 1 janar të vitit, dirigjenti gjithmonë i drejton duartrokitjet e publikut drejt violinës së parë që trajtohet në një rrafsh me dirigjentin. Kadri Veseli doli me një propozim se të gjithë ata që kanë aktakuza apo janë në një proces gjyqësor për korrupsion, krim të organizuar dhe nepotizëm duhet të dorëhiqen nga postet ose të shkarkohen. Për fat të mirë në PDK ka pak të tillë, nuk e kalojnë as 30 për qind e lidershipit. Madje, nuk kam dëgjuar për as edhe një rast të vetëm kur filan politikani e ka bërë babanë president, nënën kryeministre, vajzën apo djalin ministër kurse, për lidhjet e tjera familjare të brezit të dytë e më larg, e pranoj arsyetimin e një ish-politikani të LDK-së kur pati deklaruar në mënyrë gjeniale se: "të gjithë në Kosovë janë daja dhe nipa apo në një lidhje tjetër familjare ...". Për këtë arsye nuk shoh nepotizëm, as te PDK-ja e as te subjektet e tjera politike në Kosovë. Të parët që u flijuan për të mirën e atdheut, kombit dhe partisë, ishin Besim Beqa, Agim Çeku dhe Njazi Kryeziu. Pas "pushkatimit" deklaruan se ishte marrëveshje brenda partisë të veprohet kështu e jo se ndiejnë përgjegjësi për veprat me të cilat ngarkohen. Më parë, ambasadorët e shteteve më të fuqishme kishin kërkesë për dekriminalizim të politikës kosovare duke kërkuar pikërisht këtë për të cilën po bën përpjekje ta bëjë Kadri Veseli sikur që edhe shoqëria civile e kishte po të njëjtën kërkesë, madje ishin më këmbëngulës për këtë se vetë ambasadorët. Mbështetur në të kaluarën, del se nuk ishin të gjithë ambasadorët të "virgjër" apo imunë ndaj korrupsionit; disa merrnin përqindje nga autostradat e ndërtuara në Kosovë , disa të tjerë shitnin viza, të tjerët kacavirreshin për Trepçën etj. Kurse një pjesë e shoqërisë civile, ngushtë e lidhur me disa ambasadorë që e kishin humbur virgjinitetin në përballje me korrupsionin janë më të kriminalizuar se vet Al Kapone. Tash disa ambasadorë e patën një soft përkrahje apo përkrahje të qullët për këtë nismë e që i trimëroi "të viktimizuarit e mundshëm" ta kundërshtojnë me të gjitha mjetet këtë nismë. Shoqëria civile menjëherë, ende pa pasur kundërshtime nga PDK-ja, doli me qëndrim se Kadri Veseli po e bën këtë për poenë politikë dhe e ka filluar fushatën dhe, gati se nuk filluan të qajnë për Besim Beqën dhe Agim Çekun të cilët i kanë sulmuar natën dhe ditën, kurse Njazi Kryeziun as që e kanë njohur si peshk të madh. Bisturia e Kadrisë hyri thellë në mish, deri në kockë andaj, për shkak të dhimbjeve (politike dhe humbje të posteve), pati reagime të të fortëve brenda PDK-së. Reagoi Sokol Mali dhe Sami Drenica. Tash edhe Hajdaraga nuk po pajtohet duke e ofruar përgjegjësinë sipas shkallës së përshkallëzimit ku përfshihen disa vepra (të atyre që janë pa krahë), kurse jashtë menysë ndëshkimore mbesin disa vepra të tjera (të atyre që kanë krahë dhe që koçet i vendosin në tavolinë, në vend të argumenteve). Sami Drenica tha se nuk ka bir nëne (sigurisht edhe babe) që e përjashton nga partia... Samiu e ka një burrni dhe, edhe në rast kur të rrahë, të rrahë burrërisht. Samiu ka luajtur një rol shumë pozitiv në Skenderaj ku e ka pamundësuar përshkallëzimin e situatës dhe për këtë vlerësohet. Samiu ka pasur shumë aktakuza dhe procese gjyqësore por, se të gjitha, deri më sot janë rrëzuar. Duket se Samiu në këtë botë nuk do të mbetet pa aktakuzë. Madje, flitet se kur prokurorët nuk kanë punë për të bërë apo e bëjnë një aktakuzë fillestare (për ta mësuar zanatin) thonë, bëjeni dhe nuk kërkohet adresa, në mungesë të saj thonë: "Hajt, dërgojani Samiut..." se është mësuar me to. Tash kundër Kadrisë doli edhe "krijuesi i njerëzimit", Adami e që, sipas një automatizmi, del të jetë edhe krijues i PDK-së e që ka logjikë për faktin se njerëzimi ishte krijuar para PDK-së. Duket se nga një bri i Adamit është formuar njeriu, kurse nga një bri (pak më i butë i Ademit) është formuar PDK-ja. Edhe Xhabiri, në T7 doli kundër kryetarit dhe në mbrojtje të ligjit dhe shtetit të së drejtës. Ka të drejtë kur dihet se Xhabiri është nëna dhe baba i ligjit dhe i drejtësisë. Tash nuk po merrem fare me xhabirkat, adamkat dhe hashemitët, por se kam filluar të besoj se jam fare idiot, i ngarkuar me sindromën e Stokholmit e që nënkupton se, sa më shumë që na e ngulin, dhembshuria ndaj tyre bëhet më e madhe! Folëm pak për kasët dhe brutët kundër Kadrisë, por të shohim tani se kush është në përkrahje të kryetarit të PDK-së. Së pari u deklaruan Ilmiu dhe Dhurata. Mirëpo, nëse i referohemi shkencës dhe fizikës, përkrahjen më të madhe e mori nga Ramiz Lladrovci për faktin se, sipas teorisë së Ramizit e që, shkenca deri më sot nuk e ka përgënjeshtruar, forca e bënë fuqinë. Forca Ramiz! Kurse, disa pllazmakeksa që i sillen vërdallë Kadrisë për të përfituar materialisht (në radhë të parë) dhe politikisht që është kusht për të parën nuk patën guxim, jo ta thonë se e përkrahin, por as shkronjën 'p' të përkrahjes. Madje, një nga ta ishte mbështetur për muri nga njëri nga përbetuesit e krasëve dhe brutëve dhe ndihej më në siklet para tij se Mic Sokoli para grykës së topit! Nuk është e rastit pse Albin Kurti e refuzon pllazmakeksin!

**Kush janë 4 a 5 të fortit e PDK-së:** Pas këtyre zhvillimeve që do t'i quaja historike (edhe një pordhë nëse e bëjmë e bëjmë historike), Samia doli me një deklaratë se ata nuk janë fajtorë, por se PDK-ja ka mbetur peng e 4 a 5 personave të fuqishëm që kontrollojnë gjyqësorin, prokurorinë, mediat, bizneset, financat dhe çdo gjë që ka peshë në Kosovë. Pasi Samiu nuk përmendi fare emra, filloi bastorja (ilegale) se kush mund të jenë këta. Shumica mendojnë, jo vetëm mendojnë, por janë të bindur se në këtë katërshe janë krerët apo themeluesit e PDK-së e që nuk është fare e vërtetë. Unë, si analist i spikatur, e që këtë ma ka pranuar familja ime e ngushtë (gruaja dhe dy djemtë), sikur edhe një fqinj që në kohën e analfabetizmit pati mësuar shkrim-lexim te mulla Rrustemi, kurse deri vonë ka qenë profesor universitar, menjëherë e kam pasur të qartë se kush janë katër a pesë të fortit e PDK-së: Arsimi, Besimi, Enveri dhe Ura(ka)ni! Për të pestin kam dilema midis Hajredin Pashës dhe Bjondinë Trashes. Lëmshi filloi të shkatërrohet, ikën Arsimi dhe Besimi dhe po presim vazhdimin. Larg sheh Samiu. Largpamës apo vizionar, krejt je isto siç do të thoshin këta të Rahovecit apo doktorët e rrushit dhe të specit!

Si të ecet para, me këmbë të lidhura: Kadri Veseli me bisturinë (thikën kirurgjike) filloi të bëjë ndërhyrje të thella duke prerë thellë, deri te kokat e partisë! Se a e ka bërë këtë kokë më vete, nuk e kam të qartë. Dikush thotë se ndërkombëtarët po e përkrahin por, deri më sot del të jetë një përkrahje e lodhët që, më shumë po e dëmton shëndetin politik të Kadrisë se të "pacientëve", disa prej të cilëve janë lëshuar nga spitali i quajtur PDK, si raste që nuk kanë shërim kurse, të tjerët kanë nxjerrë mësim, prandaj po e refuzojnë shërimin. Realisht, tash, në këtë situatë mund të lajmërohen ndërmjetësuesit apo ata që pajtojnë "gjaqe" duke ofruar kompromis midis palëve që, sipas tyre, kanë dallime demokratike, por se e kanë një të përbashkët patriotike. Siç po e shihni, lexues të nderuar, kam filluar t'i bëj hapat e parë në fushën e demagogjisë praktike. Dikush do të bëjë përpjekje t'i bëjë bashkë krerët e PDK-së që, për hir të interesave kombëtare dhe shtetërore, t'i lënë pas shpine këto mosmarrëveshje teknike dhe ta bëjnë sakrificën e radhës në rrugën e shtetndërtimit apo shtetshkatërrimit, merreni si të doni dhe si t'ju pëlqejë. Nëse ndodhë kjo, humbësi më i madh do të jetë Kadri Veseli, kurse të tjerët do ta sigurojnë mbijetesën edhe për një kohë, jo shumë të gjatë. Kjo parti, nëse mbetet e tillë, nuk i duhet asgjë Kadri Veselit, as Hashim Thaçit, as Xhavitit, as Halitit, as Kamishit e as Allishverishit! Nëse vazhdon rrugëtimi i PDK-së në këtë formë dhe pa asnjë përmbajtje, AKR-ja do të mbetet parti lidere për PDK-në. Më i fortë dhe më me ndikim po del i vetmi deputet i AKR-së, Lami, se të gjithë deputetët dhe deputetet e PDK-së. Le të mësojë PDK-ja nga AKR-ja se si fitohet pushteti dhe si shantazhohet shteti. Pas Nikolo Makiavelit, Behgjet Pacolli po del strategu më i fortë se si merret pushteti. Nëse deri më sot flitet për makiavelizmin, si mënyrë më joparimore dhe më e pandershme e marrjes së pushtetit me të gjitha mjetet, nga tash, krahas makiavelizmit apo filozofisë politike të marrjes së pushtetit me të gjitha mjetet (kryesisht të ndyra) do të flitet edhe për pacollizmin. Për Kadri Veselin do të jetë shumë më mirë të largohet krejt edhe nga partia sepse, nëse pranon kompromis, do ta groposte përfundimisht, politikisht dhe moralisht! Nga përpjekjet për t'u bërë kirurg që shëron me prerje të thella dhe me rrënjë e heq mishin e keq, në rast të dorëzimit do të mbetej me bisturi (thikë kirurgjike) të kirurgut i cili, jo që nuk bënë ndërhyrje të thella, por vetëm aso sipërfaqësore, xherrah hesapi. Edhe xherrahi është kirurg, por që nuk e ka as përgjegjësinë e as lavdinë e kirurgut. Sot në Kosovë problemi më i vogël është të formoni parti: Milaim Zeka e formoi Partinë Euroatlantike që, përkthyer shqip nga fjalori politik i Oxfordit, i bie se Partia Euroatlantike është krahu politik i paktit NATO. Çka është Jens Stoltenberg për aleancën ushtarake të paktit NATO, Milaim Zeka është autoritet politik i paktit NATO.

**Për këshilltarët e Kadri Veselit:** Penelopa, gruaja e Odiseut, ka diçka të përbashkët me këshilltarët e Kadri Veselit, të dyja palët tjerrin lesh! Puna i bashkon, qëllimi i ndanë! Penelopa, pasi Odiseu u largua nga Itaka dhe se nuk dihej nëse ishte gjallë apo kishte vdekur, ishte në një hall të madh nga shkuesit. Ata e lakmonin si femër të bukur dhe si grua e një trimi dhe dijetari sikur që ishte Odiseu. Mirëpo, Penelopa e gjeti një mënyrë të përkryer t'i refuzonte ofertuesit për martesë, të qëndronte besnike ndaj burrit, por edhe të mos i ofendonte ata që e kërkonin dorën e saj. Gjatë tërë kohës tirrte leshin, bënte fije të holla dhe thurte triko (xhemperë). Të gjithëve që kërkonin dorën e saj u thoshte se e pranon ofertën e tyre, por se duhet të presin derisa të përfundojë thurja e xhemperit e ajo thurje kurrë nuk përfundonte sepse në Itakë kishte shumë dele që prodhonin shumë lesh.

Shumë këshilltarë të Kadri Veselit tërë kohën tjerrin lesh, jo për ta gjetur fillin e problemeve, por për ta ngatërruar më shumë lëmshin. Përjashtuar 2-3 veta, tjetër punë nuk dinë të bëjnë përveç të tjerrin leshin, dje të Hashimit, sot të Kadrisë, nesër mbase të Mihrisë! Në çdo vend të botës këshilltarët duhen të jenë më të mençur se ai që i japin këshilla, ndërsa Kosova, si rast sui generis, e njeh të kundërtën që budallai bëhet këshilltar! Këshilltari nuk duhet të dalë nga hija e shefit që e ka punësuar, duhet të jetë i padukshëm për publikun, por ndikues në opinion përmes atij që e këshillon. Këtu, disa këshilltarë të Kadri Veselit kur shkojnë në debate mundohen të bëhen më kadri se Kadria origjinal! Kur t'i sheh se si përhapen me duar dhe këmbë, nuk e keni të qartë se ai i keni dërguar në ndonjë meç të kikboksit apo në ndonjë kuvend zgjedhor të ndonjë dege apo nëndege të LDK-së. Për disa këshilltarë të Kadri Veselit, dëmi më i vogël do të ishte t'i vendosni në listën për asistencë sociale apo t'i fusni në listën e veteranëve mashtrues. Në këtë mënyrë dëmi do të ishte vetëm material. I përballueshëm. Shumë mirë i ka punët Kadria çfarë këshilltarësh ka. Në mesin e tyre ka këshilltarë tipikë mercenarë që janë pjesërisht të dijshëm dhe injorantë të padijshëm, të denjë për serialin "Science for stupid" (Shkenca për të marrët)! Blerimit ia heq kapelën, për mendim dhe për lexim! Për shkak të temperaturave të larta, gjykimi më është mjegulluar, që nënkupton lirim nga çdo përgjegjësi!

# 'Limak'-u investon 3 milionë euro në aeroportin 'Adem Jashari'

Përfaqësuesit e kompanisë "Limak" kanë mbajtur të hënën konferencë për medie në të cilën kanë prezantuar përgatitjet dhe investimet e bëra për sezonin e verës në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Haldun Firat Kokturk, drejtor gjeneral i aeroportit, ka njoftuar për investimet që janë bërë këtë vit në ANP "Adem Jashari". Ai ka thënë se kanë investuar tre milionë euro në pajisje dhe kanë rritur kapacitetin e operimeve



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 KORRIK - Përfaqësuesit e kompanisë "Limak" kanë mbajtur të hënën konferencë për medie, në të cilën kanë prezantuar përgatitjet dhe investimet e bëra për sezonin e verës në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".

Drejtori gjeneral në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", Haldun Firat Kokturk, ka treguar për shumën e investimeve që janë bërë këtë vit në ANP "Adem Jashari". "Për herë të parë me këto pajisje kemi investuar 3 milionë euro dhe kemi rritur kapacitetin e operimeve tona. Po ashtu, kemi investuar 600 mijë euro në IT. Operacionalisht jemi ndër kompanitë më të suksesshme në rajon", ka thënë ai.

Kokturk ka theksuar se falë investimeve dhe punës së madhe këtu në aeroportin e Prishtinës, numri i udhëtarëve është rritur për 20 për qind. "Parashikimet për muajin korrik janë se do të kemi rritje për 20 për qind. Kjo do të thotë se për herën e parë në historinë e Kosovës do të ketë me shumë se 300 mijë udhëtarë brenda një muaji. Sigurisht se këto rritje të vazhdueshme sjellin përgjegjësi të reja", ka deklaruar ai.

Kurse Shpend Maliqi, komandant i policisë në Aeroportin ANP "Adem Jashari", ka thënë se janë të përgatitur që të jenë në shërbim 24 orë. "Sikur që tha drejtori, presim një fluks të madh të qytetarëve. Për dy muaj do të kemi 600 mijë udhëtarë. Na kemi 24 orë angazhim me kapacitete 200 për qind. Kemi filluar patrullimin me armë të gjata", u shpreh Maliqi.

I pyetur se sa është numri i pjesëtarëve të sigurisë në këtë sektor, ai ka thënë se janë 105 dhe se ky numër do të rritet në vazhdimësi. "Komplet stafi jemi 105. Besoj se numri do të rritet", është shprehur Maliqi.

# Punëtorë të Lotarisë së Kosovës protestojnë para ndërtesës së qeverisë




PRISHTINË, 1 KORRIK - Rreth 100 punëtorë të Lotarisë së Kosovës kanë protestuar të hënën para ndërtesës së qeverisë duke kërkuar që të iniciohet Ligji për Lotarinë e Kosovës. Po ashtu, ata kanë kërkuar që punëtorët t'i marrin pagat, pasi qysh nga muaji prill kur janë ndaluar lojërat e fatit ata nuk janë paguar.

Përfaqësues të Sindikatës së Lotarisë së Kosovës janë pritur në takim në zyrën e kryeministrit ku edhe kanë marrë premtime se së shpejti do të iniciohet Ligji për Lotarinë e Kosovës.

Ismet Uka, anëtar i Kryesisë së Sindikatës së Lotarisë së Kosovës, ka paraqitur kërkesat e punëtorëve, duke thënë se do të protestojnë derisa të plotësohen kërkesat e tyre. "Kërkesë themelore është që të iniciohet sa më shpejt Ligji për Lotarinë e Kosovës ashtu siç është premtuar", ka thënë ai.

Uka ka bërë me dije se nga takimi që kanë pasur në zyrën e kryeministrit Haradinaj kanë marrë premtim se do të iniciohet Ligji për Lotarinë e Kosovës. Ndalimi i lojërave të fatit nga Kuvendi i Kosovës është bërë më 28 prill të këtij viti, ku nga ajo kohë Lotaria e Kosovës ka ndërprerë veprimtarinë e saj.

## Hapet afati për aplikim për rimbursim nga kuponët fiskalë për tremujorin e dytë

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar qytetarët se nga data 1 korrik deri më 30 korrik mund të aplikojnë për rimbursim nga kuponët fiskalë për tremujorin e parë të 2019-s. Sipas ATK-së, aplikimi bëhet duke plotësuar formularin për rimbursim të mjeteve nga grumbullimi i kuponëve fiskalë. "Aplikacioni duhet të plotësohet në mënyrë elektronike përmes uebfaqes së Administratës Tatimore të Kosovës në linkun Shërbime Elektronike - Aplikacioni për Kuponë Fiskalë. Aplikimi bëhet vetëm një herë për të njëjtën periudhë duke u bazuar në numrin personal të aplikuesit", thuhet në njoftimin e ATK-së.

Bëhet me dije se fituesit potencialë do të rimbursohen me 10 për qind të vlerës së deklaruar, por jo më shumë se 100 euro. "Numri minimal i kuponëve fiskalë të dorëzuar duhet të jetë 60 kuponë, me shumën minimale 250 euro. Në fund, ATK-ja kërkon që të sigurohen që xhirollogaria bankare të cilën e kanë deklaruar në aplikacion për rimbursim të jetë funksionale", është theksuar në njoftimin e ATK-së.



## Mjekët e Prizrenit fillojnë vizitat e rregullta në shtëpitë e pacientëve



PRIZREN, 1 KORRIK (ER) - Banorët e Komunës së Prizrenit, përkatësisht personat që vuajnë nga sëmundjet kronike dhe janë në fazën terminale, nga e hëna do të kenë mundësi t'i kryejnë kontrollet mjekësore nga shtëpitë e tyre falë shërbimit të kujdesit paliativ që ofrohet nga Drejtoria e Shëndetësisë e kësaj komune. Ekipet mobile të kujdesit paliativ, të përbërë nga një mjek dhe dy infermierë, kanë filluar t'i kryejnë vizitat e rregullta në shtëpitë e pacientëve për ofrimin e kontrolleve mjekësore dhe dhënien e terapisë apo këshillave mjekësore. Në kuadër të këtij projekti tashmë është krijuar një listë e pacientëve që kanë nevojë për kujdesin paliativ, ndërkaq pacientët e tjerë që kanë nevojë për këtë shërbim mund të lajmërohen në çdo kohë te numrat e telefonit 045 300 723 dhe 045 300 726, në mënyrë që të regjistrohen dhe të përfitojnë nga ky shërbim.

# Bizneset në Mitrovicë respektojnë vendimin e kryetarit Bahtiri

MITROVICË, 1 KORRIK (ER) - Bordi i Drejtorëve në Komunën e Mitrovicës ka mbajtur mbledhjen e radhës që është drejtuar nga kryetari Agim Bahtiri, e ku janë diskutuar disa çështje me interes për qytetarët e kësaj komune.
Drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka theksuar se në bashkëpunim me Policinë e Kosovës më 28 dhe 29 qershor kanë inspektuar lokalet që shkaktojnë zhurmë në orët e vona të mbrëmjes. Ahmeti ka thënë se pronarët e lokaleve duhet t'i kenë parasysh ligjet dhe rregulloret në fuqi në mënyrë që të mos detyrohen t'u shqiptojmë gjoba që do t'i dëmtonin bizneset e tyre.
Po ashtu, Ahmeti ka thënë së më 30 qershor inspektorët komunalë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë inspektuar edhe subjektet afariste lidhur me vendimin për respektimin e orarit të punës, me ç'rast vendimi i kryetarit Bahtiri, që dita e diel të jetë ditë pushimi për të gjitha bizneset në Mitrovicë, është duke u respektuar në përpikëri. Ndërsa drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka prezantuar të gjeturat nga raporti final i vitit 2018 i Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cili do të kalojë në Komitetin për Politikë dhe Financa e pastaj të procedohet në Kuvendin Komunal.




# Zonat urbane në Ferizaj bëhen me kryetarë



FERIZAJ, 1 KORRIK (ER) - Zgjedhjet në Ferizaj janë mbajtur edhe për kryetarë të zonave urbane, ku me shumicë votash kryetar i zonës së parë urbane është zgjedhur Liman Ramadani, kryetar i zonës së dytë Florim Avdiu, i zonës së tretë Alban Metushi. Kryetar i zonës së katërt është zgjedhur Bekim Shala, ndërsa i zonës së pestë urbane tash e tutje kryetar do të jetë Shkelzen Hashani, kryetar i zonës së gjashtë Bajram Prcani, i zonës së shtatë Xhelal Bislimi dhe kryetar i zonës së tetë urbane është zgjedhur Agon Qosa.
Kjo komunë është duke vazhduar zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave.
Kryetar i fshatit Balaj është zgjedhur Florim Salihu, ndërsa kryetar i fshatit Dubravë është zgjedhur Avdyl Kopili.
Në fshatin Dremjak kryetar është zgjedhur Afrim Shahini, ndërsa në fshatin Prelez i Muhaxherëve kryetar është zgjedhur Ismet Vranovci.
Zgjedhjet janë mbajtur edhe në fshatin Surqinë, ku kryetar është zgjedhur Heset Hajdini, në fshatin Manastric është zgjedhur Shaban Sejdiu, në Talinovc të Muhaxherëve kryetar është zgjedhur Njazi Behluli, në fshatin Mirash Taip Bytyqi, në Cërrnillë Shemsi Grainca dhe në fshatin Gurëz Xhafer Berisha.

# Nisin përgatitjet për mbajtjen e Festivalit Folklorik 'Oda e Llapushës'

MALISHEVË, 1 KORRIK (ER) - Është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve në Komunën e Malishevës e cila është drejtuar nga kryetari i komunës, Ragip Begaj. Në mesin e shumë çështjeve të trajtuara në këtë mbledhje është bërë me dije se janë duke u bërë përgatitjet për organizmin dhe mbajtjen e edicionit të gjashtë të Festivalit Folklorik "Oda e Llapushës".
Drejtuesit e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, kanë theksuar se janë duke punuar në mënyrë që ky festival të jetë shumë cilësor në paraqitjen e vlerave të pasura të folklorit tonë. Sipas tyre, këtë vit pritet që pjesëmarrja të jetë më e madhe në krahasim me vitet e tjera, pasi festivali e ka krijuar traditën e tij dhe interesimi për pjesëmarrje është shumë i madh.
Në këtë mbledhje edhe drejtuesit e Drejtorisë së Arsimit kanë njoftuar se ka përfunduar viti shkollor 2018-2019, ndërsa është duke vazhduar mbajtja e garave të ndryshme shkollore, ku nxënësit e kësaj komune janë duke treguar rezultate.
Po në këtë mbledhje është raportuar për fushatën e dezinsektimit selektiv kundër rriqrave, që është duke u bërë në zonat endemike, si masë parandaluese në kuadër të zbatimit të masave për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo.



# Zgjedhje për zgjidhje, apo zgjedhje për lidhje!



Ylber ÇITAKU

Temë bazë e këtij shkrimi dhe analize janë zgjedhjet e brendshme në PDK, por fillimisht dua të bëj një parantezë për zgjedhjet në përgjithësi, për zgjedhjet në Shqipëri dhe për zgjedhjet e brendshme partiake në LDK, në veçanti.
Në vendet me demokraci të zhvilluar zgjedhjet mbahen për ta respektuar ligjin, për t'i zgjedhur njerëzit e duhur, por edhe për të gjetur zgjidhje. Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve vendosen parime e kritere dhe miratohen dokumente që në thelb të përmbajtjes e kanë lirinë e mendimit dhe të shprehjes, mundësinë për të propozuar dhe për t'u zgjedhur, kritere këto të cilat në vendet me demokraci të mirëfilltë respektohen, me ç'rast zgjidhen individë e grupe që nuk kontestohen së paku për një periudhë të caktuar kohore.
Po në trojet shqiptare, ku të gjithë themi se e duam demokracinë, se e njohim dhe e respektojmë atë, për çfarë shërben mbajtja e zgjedhjeve?!
Zgjedhjet deklarativisht mbahen për t'i respektuar demokracinë, ligjin dhe kushtetutën por, në fakt, po del se zgjedhjet mbahen për interesa personale dhe grupore, për ta kënaqur ligjin dhe egot e individëve e të grupeve të caktuara pa programe e pa dokumente, ose me programe e dokumente pa mbështetje bazike në demokraci. E krijimi i paqartësive dhe situatave të mjegullta krijon hapësirë dhe mundësi për përfitime të individëve e të grupimeve të ngushta në kurriz të masave e qytetarëve.

### Zgjedhjet e 30 qershorit në Shqipëri

U bë e çfarë nuk u bë, u mbajtën protesta dhe demonstrata, humbën me miliona e miliona orë pune nëpër këto protesta, u dogjën mandatet e deputetëve me qëllimin e vetëm shtimin e presionit te qeveria dhe për sensibilizimin e faktorit ndërkombëtar. Qeveria dhe kryeministri Rama me konsekuencë e këmbëngulësi ndoqën rrugën e mbajtjes së zgjedhjeve sipas dekretit të presidentit Meta, zgjedhje këto për faktin se janë njëpartiake nuk mund të vlerësohen si pluraliste e demokratike.
Një fjalë e urtë popullore thotë "kur dy palë shtyhen, fiton i treti". Nuk di një rast të vetëm deri sot kur këtë thënie jo vetëm se e demanton, por katërçipërisht e përmbys presidenti Ilir Meta, i cili bëri e çfarë nuk bëri për t'u dalë në ndihmë z. Basha dhe znj. Kryemadhi (që është gruaja e presidentit), dekretoi 30 qershorin si datë të mbajtjes së zgjedhjeve, pastaj të njëjtin dekret e zhdekretoi; bëri e çfarë nuk bëri, vetëm që ta përfshijë faktorin ndërkombëtar në këtë proces, bëri e çfarë nuk bëri... por, në fund të fundit, si president i vendit nuk mund të jetë individ që bën çfarë t'i teket, prandaj doli humbësi më i madh i gjithë kësaj katrahure, e rrjedhimisht bashkë me të doli humbëse edhe Shqipëria, presidenti i së cilës është.
Bazuar në thënien tjetër popullore "I mbyturi të mbytë", z. Basha, duke e parë popullaritetin e paaritshëm të kryeministrit Rama, ndoqi një rrugë qorre në të cilën "mbyti" të gjithë partnerët e tij opozitarë. Sepse, në Shqipëri zgjedhjet zyrtarisht u mbajtën por, në fakt, këtu kemi të bëjmë vetëm me votim, pasi qytetari nuk pati çfarë të zgjedhë, nuk pati më shumë opsione, nuk pati pluralizëm.

### Kurse në Kosovë...

Kurse në Kosovë disa nga partitë politike po i mbajnë zgjedhjet e brendshme partiake, dy partitë kryesore të vendit, PDK dhe LDK (në fakt këto janë edhe partitë e vetme në Kosovë që u japin në një masë aromë zgjedhjeve demokratike).
Përderisa PDK-ja këtë proces pothuajse e ka çuar në fazën finale (ka mbetur të zgjidhet edhe kryesia e partisë dhe kryesitë e degëve, nga të cilat do të dalin edhe disa grupe punuese e profesionale), LDK-ja është në një fazë goxha të hershme të përmbylljes së këtij procesi.

### LDK-ja...

Ajo po ballafaqohet me një "garë", e cila, në çaste të caktuara, e humb kuptimin e zgjedhjeve të brendshme partiake, ngaqë grupe të caktuara "të fortit" mbyllin dyert e kuvendeve nëpër nëndegë e degë, kurse individë dhe grupe të tjera që ndihen të anatemuar e të injoruara reagojnë në mënyrë impulsive.
Lidershipi i LDK-së u gjet krejt i papërgatitur për këto situata e, si rezultat i kësaj, merr vendime pa i analizuar dhe pa i trajtuar ato. Rast konkret është largimi për kryetar dege i Arban Abrashit, i cili pas vetes ka lënë gjurmë, nëse për asgjë tjetër, atëherë së paku për 40 000 votat në garën për të parin e kryeqytetit në vitin 2017, e sigurisht që vendimi në pako edhe për z. Borovci, kryetar i Degës përkatëse, lë hapësirë për interpretime, ngaqë ai është një veprimtar i shquar i çështjes kombëtare, por edhe aktivist i devotshëm brenda partisë, prandaj shtrohet pyetja logjike nëse lidershipi i LDK-së e mori vendimin për rastin Abrashi & Borovci me qëllim të ndëshkimit të të njëjtëve, apo këtë vendim u përpoq ta përdorë si sinjal presioni e kërcënimi me qëllim "disiplinimin" e të tjerëve.
Secili vëzhgues neutral i këtij procesi vëren anomali në këto raste, por edhe në rastet e ngjashme, anomali e kësaj situate është fakti që ka pasur edhe raste të njëjta nëpër nëndegë të tjera, por që lidershipi i LDK-së nuk ka ndërmarrë vendime ndëshkuese, e rast konkret është ai i Mitrovicës. Ky rast ndoshta ishte edhe më i rëndë sesa ai në Mat, z. Avdullah Hoti kaloi pa pasoja, edhe për faktin se ai është i preferuar i liderit të LDK-së, z. Mustafa.
Kurse anomalia e përbashkët e të gjitha këtyre rasteve si dhe e rasteve të tjera është se njerëz me vlera krejt periferike në LDK kanë grabitur hapësirë për t'i "trajtuar" z. Abrashi, z. Borovci, z. Hoti e deri edhe z. Veliu për rastin e Podujevës sikur edhe rastet e tjera të ngjashme.

### PDK-ja...

Si anëtar i KD-së më takon më shumë të merrem me procesin zgjedhor brenda PDK-së, prandaj mund të them se kjo parti e ka afruar procesin e brendshëm zgjedhor m'u te vija e "finishit", e deri në këtë pikë u mbajtën mijëra takime përgatitore, qindra kuvende të nëndegëve dhe dhjetëra kuvende të degëve, deri te Konventa Zgjedhore e 16 qershorit, sikur dhe ajo festive një ditë më pas.
Kur të gjithë po prisnim vendosjen e pikës si shenjë pikësimi për ta shënjuar përfundimin dhe kompletimin e një procesi madhështor zgjedhor, në këtë fazë dalin në pah disa elemente që mund ta dëmtojnë rëndë procesin, por edhe vetë PDK-në, ngaqë jeta dhe historia njeh dhe di raste që individë dhe grupe të caktuara i kanë humbur "betejat", edhe pse kanë prekur vijën e "finishit", por nuk kanë arritur ta kalojnë atë.
Jam i bindur se kryetari i PDK-së, z. Veseli, me qëllimin më të mirë për PDK-në dhe vendin e ka iniciuar çështjen e pastërtisë së individëve, raste këto që individë të caktuar me "nishan" nga sistemi i drejtësisë, andaj kriteret lidhur me elementin shumë të rëndësishëm, e që është "pastërtia" e individit, duhet të jenë synim i secilit qytetar të Republikës së Kosovës, e në veçanti i liderëve të partive politike.
Më duhet ta pranoj faktin, edhe pse jam pjesë e strukturave të PDK-së, por nuk kam qenë pjesë aktive e këtij procesi zgjedhor, andaj edhe mund të gaboj, por nëse me kohë ka pasur një dokument ose porosi verbale se individët që kanë aktakuza nuk mund të zgjidhen, atëherë të njëjtëve është dashur më kohë t'u pamundësohet gara për t'u zgjedhur, e nëse me kohë nuk ka pasur një dokument ose porosi verbale se individët të cilët kanë aktakuza nuk mund të jenë pjesë e strukturave të PDK-së, atëherë kërkesa për largimin e individëve të tillë nga pozitat në të cilat janë zgjedhur në këtë proces zgjedhor, ose në proceset e mëhershme zgjedhore, mendoj se është e nxituar dhe jo e drejtë, kurse sa i përket largimit të të emëruarve, është veprim i qëlluar dhe legjitim.
Më 16 qershor 2019 është mbajtur Konventa Zgjedhore e PDK-së, atë ditë kur, ndër të tjera, është miratuar edhe Statuti i ri PDK-së si dokumenti më i lartë i partisë por, fatkeqësisht, i njëjti lë hapësirë për dykuptimësi dhe për interpretim të rasteve të caktuara.

### Statuti me dykuptimësi dhe paqartësi...

Po e marr si shembull anëtarin e KD-së të partisë i cili në vijën hierarkike është në pozitë më të ulët se kryetari i Degës apo deputeti, por neni 43 i Statutit të PDK-së, konkretisht pika 2 e këtij neni, taksativisht e përshkruan rastin e humbjes së statusit si anëtar i KD-së nëse ai dënohet me vendim të formës së prerë në kohëzgjatje prej më shumë se një viti burgim.
Kurse neni 27 i përshkruan detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të Degës, e ky nen ka disa nënpika në të cilat përshkruhen rastet e ndërprerjes së parakohshme të mandatit të kryetarit të Degës, e vlen të ceket që në asnjërën pikë nuk ceket largimi ose shkarkimi i të njëjtëve në rast se kanë aktakuzë, përveç nëse nuk merret si e mirëqenë pika 2-b) e këtij neni, në të cilin thuhet "për shkak të shkeljes së normave të Statutit", e nëse merren si norma integriteti dhe standardet, ato janë të përshkruara në nenin 78, pika 2 ku, ndër të tjera, thuhet se kandidatët e propozuar për t'u zgjedhur ose emëruar e nënshkruajnë një deklaratë të miratuar nga kryesia e partisë (kurse një deklaratë e tillë nuk është miratuar ende nga kryesia e partisë).
Në asnjë pikë të Statutit të Partisë Demokratike nuk specifikohet nëse afektohen këto raste sikur edhe shumë raste të tjera që paraqiten nëpër pika të ndryshme të këtij dokumenti në mënyrë retroaktive.
Është normale të shtrohen pyetje dhe dilema lidhur me rastet konkrete të të zgjedhurve, qofshin ata kryetarë të degëve apo deputetë, edhe pse standardet e vendosura nga kryetari Veseli janë të pranueshme për shumicën absolute të anëtarëve të strukturave të PDK-së, sikur që edhe shumica absolute e këtyre anëtarëve "lexon" midis rreshtave se këtu kemi të bëjmë me një skenar të përgatitur nga njerëz që, në fakt, mund të mos kenë aktakuza, por që pesha e tyre në njërin nga tre përbërësit kryesorë të bazamentit të PDK-së (vota) është krejt simbolike, për të mos thënë se është edhe më e vogël se 1/100 e kryetarëve të degëve apo deputetëve, e që në rastin konkret janë të atakuar.

### A po shërben pësimi si mësim?

Është për keqardhje se si PDK-ja po rrëshqet me apo pa vetëdije të lidershipit të deritanishëm në drejtim të një çarjeje. Një thënie popullore thotë nëse nuk merr mësim nga gabimet, ato të përsëriten e, siç po shihet, lidershipi i PDK-së nuk ka marrë mësim nga "çarjet" e kaluara, e me një "çarje" të ngjashme u krijua Nisma Socialdemokrate, sikur që edhe me pakënaqësitë e individëve brenda PDK-së është krijuar "brumi" i LV-së, e si përbërës kryesor ky "brum" i ka ishanëtarët e strukturave nga PDK-ja.
A nuk do të kishte qenë më mirë që hartuesit e Statutit të Partisë Demokratike të Kosovës të linin mundësi e hapësirë edhe për mendimin, qëndrimin dhe veprimin ndryshe nëpërmjet lejimit dhe legjitimimit të fraksioneve brenda partisë?!
Në situatën e krijuar, individë të caktuar me goxha ndikim në PDK, por me mungesa thelbësore te tre përbërësve kryesorë të bazamentit të PDK-së (bagazhi kombëtar, intelektual dhe vota) koordinohen për të dalë me radhë në mbështetje të kryetarit të PDK-së, edhe pse të njëjtit kuptohen qartë se nuk e kanë bërë as analizën elementare të situatës, e të tillët, fatkeqësisht, në shoqërinë tonë në rrafshin personal po avancojnë shumë, pa menduar për pasojat e tërësisë.
Jam i bindur se kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës nuk ka nevojë të ketë afër individë të tillë, aq më pak për këshillat dhe instruksionet e tyre, rrjedhimisht besoj në vizionin e kryetarit Veseli që situatës së krijuar t'i japë rrugëzgjidhje.
Të gjithë ata që marrin kurajën të flasin për këta individë me "nishan" duhet ta kenë minimumin e korrektësisë e të guximit dhe t'i bëjnë pyetje vetes, "përse unë nuk e kam një 'nishan' të tillë?"

### Të "kryqëzuarit" me "nishan"

Kryetari Veseli dhe të "kryqëzuarit" me "nishan" gjatë jetës së tyre janë gjendur para sfidave shumë më të mëdha se kjo e sotmja. Ata si shokë, miq e bashkëveprimtarë kanë gjetur rrugëzgjidhje edhe për situatat shumë më delikate e që kanë pasur të bëjnë me vetë fatin e vendit dhe të popullit, andaj unë si njëri nga anëtarët e KD të PDK-së u bëj thirrje që të uleni e të bisedoni dhe të gjeni rrugëzgjidhje, në të kundërtën "mbështetësit" e cilësdo nga palët fërkojnë duart dhe presin rastin për të marrë sa më shumë primat në majat e PDK-së, në mënyrë që nesër, nëse u jepet mundësia, ta kapin edhe primatin e të parit të PDK-së. Këto "mumje" të gjalla, të cilat suksesin dhe bagazhin e vetëm që e dinë dhe e njohin është vardisja, ka kohë që njerëzit me njërin nga tre përbërësit kryesorë të PDK-së (bagazhin kombëtar të anëtarëve) janë duke luftuar me metoda dhe strategji goxha të hapura, por të sofistikuara e perfide, gjithnjë duke i shfrytëzuar edhe dobësitë e anëtarëve në strukturat e PDK-së si njerëz me bagazh kombëtar, intelektual dhe numër të theksuar të votave, por që segmentin e djallëzive, thashethemeve, shpifjeve, intrigave dhe vardisjen nuk i njohin si veçori specifike të individëve të caktuar, rrjedhimisht nuk e kuptojnë dhe e kanë të vështirë t'i parandalojnë.

## Pompeo optimist për rifillimin e bisedimeve ShBA- Kore Veriore

UASHINGTON, 1 KORRIK - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, shprehu optimizëm lidhur me rinisjen e bisedimeve me Korenë Veriore duke thënë se të dyja palët kanë bërë "lëvizje përpara" krahasuar me një vit më parë.
Sekretari Pompeo ishte pjesë e delegacionit të presidentit amerikan, Donald Trump, gjatë takimit me udhëheqësin e Koresë Veriore, Kim Jong Un, në zonën e demilitarizuar, që ndan Korenë Veriore prej asaj Jugore.
"Mendoj se Kim dëshiron vërtet të bëjë diçka domethënëse, ashtu sikurse që ne duam ta bëjmë të njëjtën", tha Pompeo.



Trumpi dhe Kimi janë takuar dy herë në samitet e nivelit të lartë, si pjesë e përpjekjeve të ShBA-së për të bindur Phenianin të heqë dorë nga armët bërthamore. Presidenti Trump, e ka bërë arritjen e një marrëveshjeje me Kimin si gur themel të politikës së tij të jashtme.
Pasi kaloi rreth 50 minuta në bisedime pas dyerve të mbyllura me Kim, Pompeo tha se të dy palët kishin caktuar ekipet për t'i rifilluar negociatat bërthamore, por shtoi se ende nuk ka një plan pune.
Trumpi ndaloi në Korenë e Jugut gjatë kthimit nga Japonia ku mori pjesë në Samitin G20.
Ai më pas shkoi në zonën e demilitiarizuar ku takoi udhëheqësin, Kim Jong Un, dhe më pas kaloi në anën e Koresë Veriore, duke u bërë presidenti i parë amerikan që shkel në tokën e Koresë Veriore. Pas qëndrimit për disa sekonda në territorin e Koresë Veriore, Trumpi dhe Kimi u kthyen në zonën e demilitarizua për të zhvilluar takimin.
Ben Rhodes, ish-zëvendës këshilltar i Sigurisë Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, në kohën e presidentit Barak Obama, e hodhi poshtë takimin historik, si asgjë më shumë se një marifet të marketingut.
"Programi bërthamor i Koresë së Veriut është rritur qëkur Trumpi u takua për herë të parë me Kim. Kim e di se Trumpi kërkon vetëm fotografi, dhe Trumpi e di se shumica e medieve amerikane do t japin atij një fitore për një foto. Pra, këtu jemi", tha Rodos.

# Ende pa marrëveshje për pozitat e larta në BE

Holandezi socialist, Frans Timmermans, është propozuar për kreun e ri të Komisionit Evropian, Kristalina Georgieva mund të kryesojë Këshillin Evropian, ndërkaq kryeministri belg, Charles Michel është një kandidat i fuqishëm për t'u zgjedhur si shef i politikës së jashtme të BE-së, në vend të Federica Mogherinit



Kevin Lamarque (Reuters)

BRUKSEL, 1 KORRIK - Krerët e Bashkimit Evropian kanë rifilluar bisedimet në Bruksel, pasi gjatë takimit të së dielës nuk arritën pajtim për emërimet në pozitat udhëheqëse të BE-së.
Kryesuesi i samitit, Donald Tusk, bëri të ditur se po zhvillohen edhe bisedime bilaterale mes vendeve anëtare.
Ai tha se disa liderë e kanë propozuar holandezin socialist, Frans Timmermans, si kreun e ri të Komisionit Evropian.
Agjencia Reuters, raportoi se udhëheqësit e Bashkimit Evropian janë pranë vendimit për të emëruar Timmermansin si president të Komisionit Evropian, për ta zëvendësuar Jean-Claude Juncker.
Por, emërimi po përballet me kundërshtime të ashpra nga shtetet e Evropës Lindore dhe udhëheqësit e qendrës së djathtë nga grupi më i madh politik i BE-së.
Komisioni Evropian është përgjegjës për propozimin e ligjeve të reja të BE-së, zbatimin e rregullave të bllokut dhe trajtimin e marrëveshjeve tregtare.
Agjencia Reuters, raporton se dy diplomatë evropianë kanë konfirmuar se Kristalina Georgieva mund të kryesojë Këshillin Evropian.
Kryeministri i Belgjikës, Charles Michel është një kandidat i fuqishëm për t'u zgjedhur si shef i politikës së jashtme të BE-së, në vend të Federica Mogherinit, thanë dy diplomatët.
Grupi i Partive Popullore Evropiane të qendrës së djathtë donin që Manfred Weber të jetë president i Komisionit Evropian, por duket se ai do të kryesojë Parlamentin Evropian, thanë diplomatët, duke shtuar se diskutimet ende po vazhdojnë edhe pas më shumë se 18 orësh bisedimesh.

### Ku qëndrojnë mospajtimet?

Emërimet në pozitat kyçe të BE-së, i ka paraprirë një mospajtim mes kancelares gjermane, Angela Merkel dhe presidentit të Francës, Emmanuel Macron.
Kancelarja gjermane Angela Merkel mbështet Manfred Weber, konservatorin gjerman nga grupimi i Partive Popullore Evropiane të qendrës së djathtë, që është grupi më i madh politik në Parlamentin Evropian, por humbi vende në zgjedhjet e majit të BE-së.
Presidenti Macron ka sugjeruar që Weberi nuk ka përvojë politike dhe qeveritare për një pozitë të tillë të profilit të lartë.

### Kush mund të zgjidhet në pozitat e larta në BE?

Zgjedhjet për pozitat më të larta të BE-së duhet të marrin parasysh rezultatet e zgjedhjeve evropiane të muajit maj dhe të arrijnë një ekuilibër të pranueshëm për shtetet e mëdha dhe të vogla, gjininë dhe gjeografinë.
Sipas procedurës së "Spitzenkandidat" të miratuar nga BE-ja më 2014, liderët duhet të marrin parasysh se cila parti fitoi shumicën e vendeve në Parlamentin Evropian kur vendosin rolet duke përfshirë presidencën e Komisionit Evropian.
Partia Popullore Evropiane e qendrës së djathtë (PPE) mori më shumë vota në zgjedhjet e majit, por nuk ka shumicën.
Presidenti francez, Emmanuel Macron është midis atyre që kundërshtojnë procesin "Spitzenkandidat".
Në zgjedhjet e majit liberalët - duke përfshirë aleancën e Macronit dhe të Gjelbrit, shënuan rritje kështu që blloku i qendrës së djathtë dhe ai i qendrës së majtë nuk mund t'i dominojnë më vendimet në BE.
Nacionalistët gjithashtu shënuar rritje. (rfe).

## Irani njofton tejkalimin e rezervave të uraniumit të pasuruar

Teheran, 1 korrik - Irani njoftoi të hënën se ka tejkaluar kufirin e rezervave të tij të uraniumit të pasuruar në nivel të ulët, për të cilin ra dakord në marrëveshjen ndërkombëtare të vitit 2015 që synonte frenimin e zhvillimit prej tij të armëve bërthamore.
Ministri i Jashtëm Mohammad Javad Zarif i tha agjencisë së lajmeve ISNA, se "Irani e ka kaluar kufirin prej 300 kilogramësh", të rezervës së këtij lloj uraniumi.
Besohet se kjo është hera e parë që Irani shkel një nga dispozitat e marrëveshjes me gjashtë fuqitë botërore, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian, e cila u nënshkrua në shkëmbim të heqjes së sanksioneve ekonomike kundër Teheranit.
Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Mbikëqyrjen Bërthamore ka publikuar raporte të rregullta duke thënë se Teherani i është përmbajtur marrëveshjes. Presidenti amerikan Donald Trump u tërhoq nga marrëveshja vitin e kaluar, me arsyetimin se ajo nuk do ta pengonte dot Iranin për të zhvilluar armën bërthamore.






AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"



**Auto Shkolla**
**"RITMO - L"**
**Prishtinë**

**Eksperienca jonë - përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**
**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**
**Tel / kontakt:**
**044 248 173**
**044 200 604**
**044 375 333**

E rrallë

## Nëna 24-vjeçare lë foshnjën në makinë pa kondicioner për 20 minuta



Një foshnje katërmbëdhjetëmuajsh rrezikoi jetën për shkak të nënës e cila e la në makinë për të blerë alkool. Gruaja nga Oklahoma është arrestuar pasi la vogëlushin vetëm, ndërkohë që temperaturat arrinin 30-32 gradë celsius. Policia arriti në vendngjarje rreth orës 18:30 dhe vuri re makinën e parkuar.

FOTO E DITES



Udhëheqësit e Bashkësive Fetare nënshkruajnë deklaratë të përbashkët në mbështetje të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

E jashtëzakonshme

## Gjarpri që mund ta gëlltisë njeriun endet i lirë nëpër Cambridge



Pitonët që rriten në Azinë Juglindore janë gjarpërinjtë më të gjatë në botë që mund të rriten deri në dhjetë metra. Një gjarpër i tillë me gjatësi prej 2.7 metrash po qarkullon i lirë nëpër qytetin Cambridge të Anglisë, shkruan "Sky News". Autoritetet e sigurisë kanë arritur ta gjejnë pronarin, por jo edhe gjarprin. Ky lloj i gjarprit mund ta hapë nofullën aq shumë sa të jetë në gjendje ta gëlltisë një njeri.

## BARSOLETA E DITËS



**Derisa po patrullonin dy policë, njëri i thotë tjetrit:**
**- A po shkon në furrë ta blesh një byrek se kam uri?**
**Ky tjetri shkon në furrë dhe kur kthehet e pyet:**
**- Nëse e di sa byrekë kam blerë do të t'i jap që të dy.**

KINO ABC PRISHTINE

### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)**

**"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min

**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val






**Ne ora 18:00**

**"X-Men; Dark Phoenix"**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
**Regjia:** Simon Kinberg

**Në ora 20:00**

**"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,**

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
**Regjia:** F. Gary Gray







**Ne ora 22:00**

**"M A"**

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

**Regjia:** Tate Taylor

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Duket sikur kjo ditë e parë e muajit nuk është dhe aq e gëzueshme por me kalimin e orëve çdo gjë do të rregullohet në favorin tuaj.



**DEMI**
Veprimet shkojnë paralel me mendimet tuaja se si duhet finalizuar një projekt. Keni qenë gjithmonë mjaft praktikë dhe kjo ju ndihmon ngado.



**BINJAKËT**
Sot jeni të fokusuar vetëm tek ndjenjat dhe tek dashuria. Për ata që janë çift partneri është kryefjala e ditës.



GAFORRJA
Intuita juaj ju ka ndihmuar të zgjidhni opsionin e duhur në një marrëveshje të momenteve të fundit.



**LUANI**
Mendja juaj ka kohë që mendon për vende të largëta. Doni të zhvendoseni diku por do të jetë një vendim definitiv.



VIRGJERESHA
Do të dëgjoni shumë fjalë sot por asnjëra prej tyre nuk do të rezultojë e vërtetë në fund të ditës, duke bërë që të dilni keq përpara një miku.



PESHORJA
Keni një ngërç në raportin me partnerin që nuk po arrini dot ta tejkaloni as ju as pala tjetër. Do t'ju çojë drejt një ftohjeje akoma më të madhe



**AKREPI**
Yjet nuk janë në anën tuaj sot dhe do t'ju pengojnë në ato pjesë të ditës që i mendonit si më të mirat dhe më të realizuarat.



SHIGJETARI
Keni mjaft punë për të mbyllur sot edhe ato gjëra që i keni lënë për një moment të dytë por që nuk mund të presin më.



BRICJAPI
Stabiliteti dhe mirëqenia e familjes tuaj janë ato që po ju shqetësojnë sot. Një problem i lindur së fundmi ju ka vënë në mendime.



**UJORI**
Nuk është një nga ato ditët më të mira kjo e sotmja por do të dini t'i jepni ngjyra edhe pse paraqitet shumë gri.



**PESHQIT**
Jeni shumë të ndjeshëm sot dhe emotiviteti juaj do të jetë ngjitës. Në ambientin shoqëror do t'ju bashkohen edhe miqtë në të njëjtën gjendje.

# Celine Dion ndryshon pesë herë veshjen brenda një dite në Paris



Celine Dion është duke e vizituar kryeqytetin francez për Javën e Modës. Por, këngëtarja 51-vjeçare duket se po e shfrytëzon kohën e saj në Paris edhe për ta shfaqur gjithë stilin e tij. Madje, Dioni është parë duke ndryshuar pesë herë veshjen brenda ditës. Ajo ka ndryshuar veshjet fillimisht për një fotosesion derisa më vonë është parë edhe duke shëtitur me biçikletë në Kullën Eiffel.



# Ledri Vula takohet me Rita Orën, bëjnë fotografi bashkë

Në Cyrih të Zvicrës është duke u mbajtur Festivali i Muzikës "Alba Festival". Në këtë festival do të performojnë këngëtarë të njohur shqiptarë. Një ndër këta këngëtarë është edhe Rita Ora. Në "Alba Festival" është paraqitur edhe Ledri Vula, ky i fundit ka shpërndarë një fotografi me Rita Orën në "Instagram".

# Kylie dhe Stormi Jenner vishen njëjtë



Ylli i njohur televiziv, Kylie Jenner, gjatë tërë kohës ka thënë se ëndrra dhe dëshira më e madhe e saj është të bëhet nënë. Jenner këtë e dëshmon çdoherë duke treguar përkushtimin dhe dashurinë që ka ndaj vajzës së saj, Stormi. Kylie në rrjete sociale ka ndarë disa fotografi të veta dhe vajzës ku shihen se janë të veshura njësojë. Nënë e bijë duken shumë bukur në këtë veshje.

# Adrian Gaxha e pranon se është në lidhje



Pas përfundimit të një lidhje kohë më parë këngëtari Adrian Gaxha ka gjetur sërish dashurinë. "Prive" muaj më parë ka raportuar se artisti është në lidhje me një vajzë nga Kosova, saktësisht nga qyteti i Ferizajt me inicialet e së cilës janë S. D. Vajza në fjalë mbante dhe ende e mban edhe shkronjën e parë të emrit të këngëtarit, në biografinë e saj në "Instagram". Ndërsa javën që lamë pas në "Prive", Gaxha e pranoi haptazi se ende është në lidhje duke mos dhënë të tjera të hollësishme.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Prishtina kërkon kualifikimin

Sot nga ora 17:45 në Gjibraltar zhvillohet ndeshja kthyese e Ligës së Evropës në mes St Joseph's dhe Prishtinës. Skuadra nga Kosova, edhe përkundër që luajti në ndeshjen e parë baras (1-1), sot e kërkon kualifikimin në rrethin tjetër




"Epoka e re"

PRISHTINË, 1 KORRIK - FC Prishtina sot (e martë) e zhvillon ndeshjen kthyese ndaj St Joseph's me shpresën që do të arrijë të kualifikohet në raundin tjetër. Për të arritur një sukses të tillë, skuadra "bardhekaltër" do të djersitet mirë për faktin se në ndeshjen e parë parakualifikuese në Ligën e Evropës të zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë luajti baras (1-1).

Skuadra e drejtuar nga Mirel Josa ka mbajtur të hënën stërvitjen e fundit para ndeshjes që zhvillohet të martën nga ora 17:45 në Gjibraltar. Gazeta ka provuar të marrë deklarata nga lojtarët lidhur me këtë ndeshje shumë të rëndësishme për skuadrën e Prishtinës, por ata janë deklaruar se nuk iu lejohet të japin deklarata për medie.

Ndërsa trajneri Mirel Josa, pas barazimit në ndeshjen e parë, e kishte pranuar se kualifikimi do të jetë një mision i vështirë për kualifikimin në raundin tjetër. "Do të jetë vështirë edhe në ndeshjen e kthimit sepse kemi përballë një ekip që i shfrytëzon të gjitha armët, madje edhe vonimin e lojës", kishte deklaruar Josa.

Për ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" ishte deklaruar edhe Meriton Korenica, i cili është kthyer nga lëndimi pas dy muajve mungesë në formacionin e skuadrës kryeqytetas. "Fati na ktheu shpinën pasi që rastet i patëm dhe nuk i shfrytëzuam në maksimum dhe shpresoj në lojën tjetër të vazhdojmë dhe të kualifikohemi", kishte deklaruar Korenica.

Një lajm i keq për Prishtinën në prag të ndeshjes me St Joseph's është se Alban Shillova nuk mund të paraqitet, kurse edhe dy transferimet e reja, Ahmed Januzi dhe Tun Bardhoku, nuk do të kenë të drejtë të paraqiten, pasi ish-klubet e tyre, Llapi dhe Vëllaznimi, nuk lejuan një gjë të tillë.

SHKURT

### Tumbakoviqi bojkotoi ndeshjen ndaj Kosovës, Serbia e shpërblen

Federata Serbe e Futbollit ka emëruar Lubisha Tumbakoviq trajner të ri të kombëtares. 66-vjeçari u shkarkua nga Mali i Zi muajin e shkuar, pasi bojkotoi përballjen ndaj Kosovës, të vlefshme për eliminatoret e Evropianit. Ky bojkot erdhi për arsye "patriotike", teksa tekniku serb arriti t'i bindte edhe disa futbollistë të tjerë që të mos aktivizoheshin. Tumbakoviqi do ta zërë vendin e Mladen Krstajiqit i cili u shkarkua pas humbjes turpëruese 5-0 ndaj Ukrainës.

### Nikaj premton rikthimin e Lirisë në Superligë

Samuel Nikaj është trajner i Lirisë nga Prizreni për edicionin 2019/2020. Ai e ka quajtur skuadrën nga Prizreni si më traditë të madhe dhe ka premtuar se do të drejtojë në rrugëtimin drejt rikthimit në Superligë. "Për mua sot fillon dita e parë e punës në klubin me shumë traditë, Liria. Jam i nderuar që m'u besua ta udhëheq klubin drejt Superligës, vend ku dhe i takon të jetë. Falënderoj kryesinë e klubit që pati besim tek unë. Do ta bëj të pamundurën t'i justifikoj pritshmëritë e tyre dhe të tifozëve", ka thënë Nikaj.

### Fillon afati kalimtar për hendbollistë

Ka filluar afati kalimtar për hendbollistë në Kosovë. Bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës ka vendosur që afati i rregullt kalimtar për edicionin 2019\2020 të jetë i hapur prej 1 korrikut deri më 15 korrik. Gjatë afatit lojtarët, përveçse mund të kalojnë prej klubit në klub, mund ta marrin edhe statusin e lojtarit të lirë. Ata më pas mund të regjistrohen në klubet e reja deri më 15 tetor. Ndërsa lojtarët që vijnë nga shtetet e tjera mund të regjistrohen edhe pas afatit kalimtar, përkatësisht deri në fund të shkurtit të vitit të ardhshëm. Bordi i FHK-së ka vendosur edhe për fillimin e kampionatit të ri. Kështu Superliga në të dy konkurrencat do të fillojë më 14 shtator.

## Kosova, e 34-ta në Lojërat Evropiane

PRISHTINË, 1 KORRIK - Kosova i ka mbyllur me plot sukses Lojërat Evropiane. Kosova e mbylli këtë kompeticion prestigjioz i cili u mbajt në Bjellorusi, në pozitën e 34-t pasi fitoi tri medalje, një të artë, një të argjendtë dhe një të bronztë Kosova i mbyllur me plot sukses garat në Lojërat Evropiane, të cilat u mbajtën në Bjellorusi nga 21 deri më 30 qershor. Vendi ynë e mbylli këtë garë prestigjioze në pozitën e 34-t. Kosova siguroi tri medalje në "Minsk 2019" falë sportit të xhudos. Majlinda Kelmendi e fitoi medaljen e artë në kategorinë 52 kilogramë, Nora Gjakova të argjendtën në 57 kilogramë dhe Loriana Kuka të bronztën në kategorinë deri në 78 kilogramë. Kosova mori pjesë në Lojërat Evropiane me 12 garues. Marrë në përgjithësi, Kosova mund të jetë e kënaqur me performancat e garuesve të saj. Në Lojërat Evropiane "Baku 2015", që ishin edhe debutuese, Kosova e kishte fituar vetëm një medalje falë Nora Gjakovës.



## Mucaj, largimi i nëntë nga Ballkani

SUHAREKË, 1 KORRIK - Ledjon Mucaj e dërgon në nëntë numrin e lojtarëve të larguar nga skuadra e Ballkanit në këtë afat kalimtar. Futbollisti Mucaj ndarjen me skuadrën nga Suhareka e ka zyrtarizuar nëpërmjet një postimi në "Facebook". "Nga sot nuk jam më futbollist i FC Ballkanit. Unë i kam kërkuar presidentit të më lejonte ta vazhdoj karrierën jashtë dhe i jam shumë falënderues për mirëkuptimin. Dua t'i falënderoj shokët e ekipit, pasi ma bënë më të thjeshtë përshtatjen. Dua të falënderoj trajnerin Sami Sermaxhaj për besimin e dhënë dhe stafin e FC Ballkanit. Për mua ishte një përvojë e bukur dhe më vjen mirë që ekipi mbeti në ligë dhe bëra vërtet miq të mirë. Suksese në vazhdim FC Ballkanit!", ka shkruar Mucaj. Futbollistët e tjerë të larguar nga Ballkani në këtë afat kalimtar janë Leart Emini, Dardan Jashari, Gentian Elezi, Ilir Gegaj, Leotrim Gashi, Almir Ajzeraj, Borche Manevski, Aldin Adzoviq. Ndërsa Jetmir Topalli dhe Arber Potoku janë të huazuar në skuadrën e Feronikelit për ndeshjet ndërkombëtare.



# Gjilani ndez 'motorët' për edicionin e ri



GJILAN, 1 KORRIK - Ashtu siç edhe ishte planifikuar, skuadra e Gjilanit të hënën në mëngjes mbajti grumbullimin e parë për edicionin e ri garues 2019/2020, ku edhe nisi fazën përgatitore për këtë sezon. Mes një atmosfere pozitive futbollistët e Gjilanit dhe prurjet e reja patën mundësinë që në grumbullimin e parë të njoftohen nga afër me bashkëlojtarët e tyre, me të cilët nisën një rrugëtim të ri në fanellën e klubit nga Anamorava. "Para fillimit të seancës stërvitore i pranishëm ishte edhe presidenti i klubit, Florim Zuka, i cili i përshëndeti të gjithë futbollistët dhe u uroj mirëseardhje futbollistëve të rinj të Gjilanit. Ai tutje u dëshiroi shëndet dhe një kampionat të mirë e me shumë rezultate pozitive të gjithë futbollistëve, të skuadrës kuq e bardh të Gjilanit", thuhet në njoftimin e skuadrës së Gjilanit.
Seanca stërvitore e cila ishte dhe e para, ishte kryesisht e lehtë dhe ajo filloi me një vrapim të lehtë. Numri një i shtabit teknik, Gentjan Mezani, së bashku me ndihmësin e tij Alban Hyseni dhe trajnerin e portierëve Afrim Ajdini në programin e stërvitjes kishin planifikuar edhe disa ushtrime të tjera fizike dhe disa teknike, ku në vazhdimin e stërvitjes futbollistët punuan edhe me top. Të pranishëm ishin të gjithë futbollistët e skuadrës.

# Rossi: Nuk ndihem qetë me këtë motor



